# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 25

**Tiranë – E hënë, 2 shkurt 2026**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 23.1.2026 | Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për përdorimin e fondit për blerjen e një pasurie të paluajtshme që do të shërbejë si seli e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Londër, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut..... | 2119 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 28.1.2026 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës–Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)'", të ndryshuar..... | 2120 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 52, datë 28.1.2026 | Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 3204, fshati Rrakull, Njësia Administrative Synej, Bashkia Kavajë, qarku Tiranë, nga shoqëria *"Select Energy"* sh.p.k..... | 2122 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 28.1.2026 | Për organizimin, funksionimin dhe detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit..... | 2124 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 28.1.2026 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale)".... | 2126 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 28.1.2026 | Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë "*Innovation4Albania*".... | 2132 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 28.1.2026 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar..... | 2136 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 60, datë 28.1.2026 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar..... | 2138 |
| Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 13.1.2026 | Çështja Tashi kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 1351/19)*..... | 2140 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 70, datë 6.11.2025 | Me objekt shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatë së Lartë.<br>Refuzimin e ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini *alias* Imami nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë.<br>Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimin për lejimin e ekstradimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese..... | 2144 |
| Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 127, datë 16.1.2026 | Autorizim i ndihmës shtetërore "Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale për periudhën 2026–2028" ..... | 2150 |

**VENDIM**
**Nr. 47, datë 23.1.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE E TË PROCEDURAVE PËR PËRDORIMIN E FONDIT PËR BLERJEN E NJË PASURIE TË PALUAJTSHME QË DO TË SHËRBEJË SI SELI E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LONDËR, MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE E IRLANDËS SË VERIUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 13, të nenit 11, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në vijim "Ministria", dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Londër, në vijim "Ambasada", realizojnë procedurën e blerjes së një pasurie të paluajtshme në Londër, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut, e cila do të shërbejë si seli e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Londër, me një fond limit jo më shumë se 520 000 000 (pesëqind e njëzet milionë) lekë, sipas rregullave dhe procedurave, të parashikuara në këtë vendim.

2. Kreu i misionit identifikon pasuritë e paluajtshme, të llojit "ndërtesë" dhe "truall", të cilat kanë hapësirën e nevojshme për ushtrimin funksional dhe në perspektivë të aktivitetit diplomatik e konsullor, vendndodhjen dhe distancën e përshtatshme nga institucionet qendrore të shtetit pritës dhe garantojnë sigurinë fizike, kanë status të lirë nga çdo ngarkesë apo barrë hipotekore, si dhe nuk kanë kufizime juridike me natyrë përmbarimore dhe gjyqësore, dhe propozon jo më pak se 3 (tri) oferta pranë Komisionit, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

3. Për vlerësimin e ofertave ngrihet një Komision i Posaçëm, i kryesuar nga zëvendësministri përgjegjës për punët e jashtme, në përbërje të të cilit ka përfaqësues në nivel drejtues nga:

a) Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;

b) Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare;

c) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar;

ç) Avokatura e Shtetit.

4. Komisioni ka këto detyra kryesore:

a) Shqyrton ofertat e paraqitura për blerjen pasurisë së paluajtshme, të propozuara, duke vlerësuar plotësimin e kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, si dhe kostot financiare të ofertave të propozuara;

b) Mbikëqyr kreun e misionit në procesin e negociatave për blerjen e pasurisë së paluajtshme dhe lidhjen e kontratës së shitblerjes;

c) Sipas nevojës, vlerëson në terren gjatë procesit të negociatave përmbushjen e kushteve të përgjithshme, sipas pikës 2, të këtij vendimi;

ç) Vlerëson kushtet e projektkontratës së shitblerjes së negociuar;

d) Vendos shpalljen e ofertës fituese ose skualifikimin e ofertave, sipas rastit.

5. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave, Komisioni i paraqet ministrit një relacion përmbledhës për procedurën e ndjekur dhe vendimmarrjen e tij.

6. Në rastin kur Komisioni ka shpallur një ofertë fituese, ministri autorizon kreun e misionit për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

7. Pranë ministrisë ngrihet një sekretariat teknik *ad hoc,* i cili ka këto detyra:

a) Asiston Komisionin në mbarëvajtjen e aktivitetit të tij;

b) Organizon takimet e Komisionit;

c) Administron dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor për procedurën e blerjes.

8. Pas nënshkrimit të kontratës, ministria autorizon Ambasadën që të kryejë pagesat për blerjen e pasurisë së paluajtshme, sipas detyrimeve kontraktore dhe për mbulimin e tarifave shoqëruese që lidhen me finalizimin e procedurës së blerjes.

9. Pas nënshkrimit të kontratës, kreu i misionit merr të gjitha masat për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, sipas legjislacionit të shtetit pritës.

10. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i ministrisë për vitin 2025.

11. Institucionet, sipas pikës 3, të këtij vendimi, caktojnë përfaqësuesit në Komision, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Avokatura e

Shtetit dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 51, datë 28.1.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 19, DATË 17.1.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE DURRËS – TERMINALI I TRANSPORTIT PUBLIK TIRANË (PPT) DHE LIDHJA ME AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)'", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

I. Në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", "truall" dhe "vreshtë", me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 377 326 511.55 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë) lekësh.".

2. Në pikën 4, togfjalëshi "... prej 280 445 392.25 (dyqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë njëzet e pesë) lekësh ..." zëvendësohet me "... prej 377 326 511.55 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e treqind e njëzet e gjashtë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e pesë) lekësh ...".

3. Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Vlerat e shpronësimit të pasurive të paraqitura në nënndarjet me numrat rendorë 9, 11, 12, 15, 17, 18, 40, 41, 42, 43, 55, 57, 65, 73 dhe 74 zëvendësohen me vlerat e shpronësimit në nënndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Pas nënndarjes me numër rendor 84 shtohen pasuritë që shpronësohen, të paraqitura në nënndarjet me numra rendorë nga 85 në 115, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga shoqëria "Hekurudha Shqiptare" sh.a.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria "Hekurudha Shqiptare" sh.a., drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamzë Vorë, Tiranë Rurale 2 dhe Krujë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

TABELA E NDRYSHIMEVE DHE SHTESAVE NË LISTËN E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN ME VENDIMIN NR. 19, DATË 17.1.2024, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE DURRËS – TERMINALI I TRANSPORTIT PUBLIK TIRANË DHE LIDHJA ME AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)'", TË NDRYSHUAR

| Nr. rendor | Emri | Atësia | Mbiemri | Fshati ose qyteti | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Arë (m²) | Truall (m²) | Ndërtesë | Volumi | Faqe | Sip. e shpronësuar "arë" | Çmimi (lekë/m²) | Vlera në lekë | Sipërfaqja truall shtesë (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | Çmimi njësi i kulturës bujqësore (jonshe 9.5 lekë/m², misër 8.6 lekë/m²) | Vlera e kulturës bujqësore (lekë) | Vlera e dru-frutorëve (lekë) | Investime (lekë) | Tokë e pashfytëzueshme (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera e tokave të pashfytëzueshme (lekë) | Vlera totale (lekë) | SHËNIME (kufizime hipotekare barre mbi pasurinë ekz.) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | SAMI | ALI | HAKA | BERXULL | 1167 | 480/63 | ARE | 22506 | 22506 | | | 14 | 71 | 1,389.00 | 6,461.95 | 8,975,648.55 | | | - | | | - | - | 517.37 | 6,461.95 | 3,343,219.07 | 12,318,867.62 | |
| 11 | XHEMAILE<br>ALTIN<br>AGRON | HARIF<br>XHEMAL<br>XHEMAL | HAKA<br>HAKA<br>HAKA | BERXULL | 1167 | 310/9 | ARE | 4000 | 4000 | | | 4 | 167 | 1,270.00 | 2,114.82 | 2,685,821.40 | | | - | 9.50 | 12,065.00 | - | - | 257.93 | 2,114.82 | 545,475.52 | 3,243,361.92 | |
| 12 | IDRIZ | ABDULLA | HAKA | BERXULL | 1167 | 310/12 | ARE | 4000 | 4000 | | | 4 | 170 | 1,430.00 | 2,114.82 | 3,024,192.60 | | | - | 9.50 | 13,585.00 | - | - | 40.02 | 2,114.82 | 84,635.10 | 3,122,412.70 | |
| 15 | IBRAHIM | SHABAN | HAKA | BERXULL | 1167 | 203/4 | ARE | 5300 | 5300 | | | 3 | 60 | 2,688.00 | 2,114.82 | 5,684,636.16 | | | - | 9.50 | 25,536.00 | - | - | 674.24 | 2,114.82 | 1,425,896.24 | 7,136,068.40 | |
| 17 | LUME<br>AGIM<br>LUTFI<br>FATMIR<br>ARTAN<br>ALBAN | XHELADIN<br>LIMAN<br>LIMAN<br>LIMAN<br>LIMAN<br>LIMAN | REZI<br>REZI<br>REZI<br>REZI<br>REZI<br>REZI | BERXULL | 1167 | 134/10 | ARE | 7900 | 7900 | | | 12 | 153 | 735.00 | 2,114.82 | 1,596,689.10 | | | - | | | - | - | 649.29 | 2,114.82 | 1,373,131.48 | 2,969,820.58 | |
| 18 | AGIM | LIMAN | REZI | BERXULL | 1167 | 134/12 | ARE | 5100 | 5100 | | | 12 | 161 | 605.00 | 2,114.82 | 1,279,466.10 | | | - | 9.50 | 5,747.50 | | | 192.82 | 2,114.82 | 407,779.59 | 1,692,993.19 | |
| 40 | MITUSH | ZEJNEL | LAMA | QEREKË | 3096 | 231/6 | ARE | 13780 | 13780 | | | 4 | 42 | 2,250.87 | 5,287.05 | 11,900,462.23 | | | - | | | - | - | | | | 11,900,462.23 | |
| 41 | MITUSH | ZEJNEL | LAMA | QEREKË | 3096 | 231/5 | ARE | 3562 | 3562 | | | 4 | 40 | 1,171.03 | 5,287.05 | 6,191,294.16 | | | - | | | - | - | 180.02 | 5,287.05 | 951,774.74 | 7,143,068.90 | |
| 42 | HAZIR | BAFTJAR | LAMA | QEREKË | 3096 | 231/4 | ARE | 20952 | 20952 | | | 4 | 42 | 4,023.14 | 5,287.05 | 21,270,342.34 | | | - | | | - | - | | | | 21,270,342.34 | |
| 43 | ILIR | SAMI | JATA | QEREKË | 3096 | 231/3 | ARE | 19909 | 19909 | | | 4 | 60 | 3,198.24 | 5,287.05 | 16,909,254.79 | | | - | | | - | - | | | | 16,909,254.79 | |
| 55 | JEMEN | REZA | XHISHA | BERXULL | 1167 | 311/7 | ARE | 900 | 900 | | | 4 | 177 | 67.11 | 2,114.82 | 141,925.57 | | | - | 9.50 | 152.00 | | - | 130.83 | 2,114.82 | 276,681.90 | 418,759.47 | |
| 57 | ASTRIT<br>BEDRIJE<br>ERALD<br>HAXHI<br>BESNIK | | LOCI<br>LOCI<br>LOCI<br>LOCI<br>LOCI | BERXULL | 1167 | 201/4 | ARE | 11400 | 11400 | | | 3 | 51 | 1,384.00 | 2,114.82 | 2,926,910.88 | | | | 9.50 | 13,148.00 | | | 41.55 | 2,114.82 | 87,870.77 | 3,027,029.65 | |
| 65 | MERITA | HAXHI | LALA | BERXULL | 1167 | 52/26 | ARE | 2000 | 2000 | | | 14 | 75 | 1,463.00 | 2,114.82 | 3,093,981.66 | | | - | 9.50 | 13,898.50 | | - | 526.90 | 2,114.82 | 1,114,298.66 | 4,222,178.82 | |
| 73 | MYSLYM | BESIM | KLIQO | KAMZE | 1649 | 2/8 | ARE | 6400 | 6400 | | | 3 | 207 | 1,929.78 | 2,114.82 | 4,081,137.34 | | | - | | | 82,685.00 | - | 231.68 | 2,114.82 | 489,961.50 | 4,653,783.84 | |
| 74 | RAMIZ | MUSA | SADIKU | KAMZE | 2066 | 2/13 | ARE | 6400 | 6400 | | | 3 | 132 | 3,759.60 | 2,114.82 | 7,950,877.27 | | | - | 9.50 | 24,168.00 | - | - | | | | 7,975,045.27 | |
| 85 | ENVER | MEHMET | GJANA | QEREKË | 3096 | 231/2 | ARE | 3708 | 3708 | | | 4 | 38 | 1,548.48 | 5,287.05 | 8,186,891.18 | | | | | | | | | | | 8,186,891.18 | |
| 86 | ALBANIA CAR RENTAL | | | QEREKË | 3096 | 231/18 | ARE | 18100 | 18100 | | | 12 | 220 | 58.40 | 5,287.05 | 308,763.72 | | | - | | | | | | | | 308,763.72 | Seksioni D. Nr. reg 1841,952, datë reg. 31.8.2023, kontratë për vendosjen e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka sipas vlerave të kredisë. |
| 87 | ALBANIA CAR RENTAL | | | QEREKË | 3096 | 231/19 | ARE | 2500 | 2500 | | | 12 | 221 | 833.70 | 5,287.05 | 4,407,813.59 | | | - | | | | | | | | 4,407,813.59 | Seksioni D. Nr. reg 1841,952, datë reg. 31.8.2023, kontratë për vendosjen e hipotekës për garantimin e kredisë së dhënë nga banka sipas vlerave të kredisë. |
| 89 | AGO | SHEME | HOXHA | MARIKAJ | 2596 | 143/14 | ARE | 666 | 666 | | | 15 | 76 | 327.1 | 2,686.00 | 878,510.02 | | | | | | | | 338.90 | 2,686.00 | 910,283.40 | 1,788,793.42 | |
| 90 | SEHIT | VESEL | MORA | MARIKAJ | 2596 | 81/15 | ARE | 780 | 780 | | | 15 | 74 | 421.13 | 2,686.00 | 1,131,155.18 | | | - | | | | | | | | 1,131,155.18 | |
| 91 | TOKË SHITET - XHAVIT PICARI | | | MARQINET | 2605 | X15 | | 560 | | | | 9 | 7 | | | | | | - | | | | 883,568.10 | | | | 883,568.10 | |
| 92 | TOKË SHITET - GERALD PICARI | | | MARQINET | 2605 | X15 | | 11.025 | | | | 9 | 7 | | | | | | - | | | | 292,578.70 | | | | 292,578.70 | |
| 93 | TOKË SHITET - VELI PICARI | | | MARQINET | 2605 | X15 | | | | | | 9 | 7 | | | | | | | | | 337,008.00 | 171,538.41 | | | | 508,546.41 | |
| 94 | JONUZ | HYSEN | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 2/1 | ARE | 300 | 300 | | | 7 | 231 | 133.70 | 6,290.00 | 840,973.00 | | | - | | | | - | | | | 840,973.00 | |
| 95 | AGIM | MUHAREM | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 2/2 | ARE | 250 | 250 | | | 7 | 240 | 187.00 | 6,290.00 | 1,176,230.00 | | | - | | | | - | | | | 1,176,230.00 | |
| 96 | HAMDI | HASAN | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 2/3 | ARE | 427 | 427 | | | 9 | 242 | 226.10 | 6,290.00 | 1,422,169.00 | | | - | | | | - | | | | 1,422,169.00 | |
| 97 | ZENEL | HASAN | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 2/4 | ARE | 516 | 516 | | | 10 | 47 | 243.80 | 6,290.00 | 1,533,502.00 | | | - | | | | - | | | | 1,533,502.00 | |
| 98 | GANI | BAJRAM | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 2/6 | ARE | 1600 | 1600 | | | 10 | 177 | 666.40 | 6,290.00 | 4,191,656.00 | | | - | | | | - | | | | 4,191,656.00 | |
| 99 | ANDRA<br>DONALD<br>VALBONA | MUHEDIN<br>KRISTO<br>KUJTIM | TEJHALLARI<br>TEJHALLARI<br>GANAJ | MUÇAJ | 2726 | 2/7 | ARE | 1020 | 1020 | | | 5 | 77 | 369.70 | 6,290.00 | 2,325,413.00 | | | - | | | | - | | | | 2,325,413.00 | |
| 100 | HAMDI | HASAN | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 11/39 | ARE | 937.5 | 937.5 | | | 9 | 7 | 336.8 | 6,290.00 | 2,118,472.00 | | | - | | | | - | | | | 2,118,472.00 | |
| 102 | HAMDI | HASAN | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 11/60 | ARE | 937.5 | 937.5 | | | 9 | 8 | 335.40 | 6,290.00 | 2,109,666.00 | | | - | | | | - | | | | 2,109,666.00 | |
| 103 | ZENEL | HASAN | DERVISHI | MUÇAJ | 2726 | 11/62 | ARE | 2750 | 2750 | | | 10 | 130 | 945.40 | 6,290.00 | 5,946,366.00 | | | - | | | | - | | | | 5,946,366.00 | |
| 104 | AFERDITA | ZENEL | DRIO | MUÇAJ | 2726 | 11/63 | ARE | 810 | 810 | | | 10 | 131 | 270.60 | 6,290.00 | 1,702,074.00 | | | - | | | | - | | | | 1,702,074.00 | |
| 105 | HILLDON | SULEJMAN | SHKEMBI | BERXULL<br>KODER | 1167 | 1075/5 | VRESHTE | 223 | 223 | | | 11 | 71 | 110.36 | 6,290.00 | 694,164.40 | | | - | | | | | | | | 694,164.40 | |
| 106 | SHABAN | GANI | ALEMETA | BERXULL<br>KODER | 1167 | 1082/6 | ARE | 3600 | 3600 | | | 13 | 72 | 237.80 | 6,290.00 | 1,495,762.00 | | | - | | | | - | | | | 1,495,762.00 | |
| 107 | XHEVRIE | GANI | LIKA | BERXULL<br>KODER | 1167 | 1082/3 | TRUALL | 1000 | | 1000 | | 12 | 170 | | | - | 95.60 | 6,290.00 | 601,324.00 | | | | | | | | 601,324.00 | |
| 108 | ABDULLA | RAMAZAN | KONI | BERXULL | 1167 | 311/59 | ARE | 1500 | 1500 | | | 16 | 114 | 113.05 | 2,114.82 | 239,080.40 | | | | | | | | 192.96 | 2,114.82 | 408,073.67 | 647,156.07 | |
| 109 | KUJTIM<br>REZARTA | QEMAL<br>QEMAL | LLAGAMI<br>DEMNERI | BERXULL | 1167 | 133/35 | ARE | 4000 | 4000 | | | 13 | 127 | 971.00 | 2,114.82 | 2,053,490.22 | | | - | | | 71,500.00 | | | | | 2,124,990.22 | |
| 110 | ALI | ARIF | TOTA | MEZEZ | 2679 | 60/80 | ARE | 325 | 325 | | | 23 | 43 | 58.50 | 7,049.40 | 412,389.90 | | | - | | | | | | | | 412,389.90 | |
| 111 | ENVER | ABAZ | LUSHI | MEZEZ | 2679 | 60/83 | ARE | 130 | 130 | | | 23 | 46 | 45.00 | 7,049.40 | 317,223.00 | | | - | | | | | | | | 317,223.00 | |
| 112 | ALI<br>ENVER | ARIF | TOTA<br>LUSHA | MEZEZ | 2679 | 60/87 | ARE | 195 | 195 | | | 23 | 156 | 109.50 | 7,049.40 | 771,909.30 | | | - | | | | 442,120.20 | | | | 1,214,029.50 | |
| 113 | ALI | ARIF | TOTA | MEZEZ | 2679 | 60/77 | ARE | 90 | 90 | | | 23 | 40 | 52.30 | 7,049.40 | 368,683.62 | | | - | | | | | | | | 368,683.62 | |
| 114 | SUPERBETON - MATI (Investim) | | | MEZEZ | 2679 | 60/92 | PALLAT | 3600 | | 3600 | | 27 | 177 | | | - | | | - | | | | 2,386,015.30 | | | | 2,386,015.30 | Seksioni D. Vendoset sekuestro konservative nga Zyra Përmbaruese "Debit Collection" sh.p.k., shkresa nr. 229 prot. Nr. 221, reg. datë 15.3.2018, protokolluar ZVRPP nr. 8320, datë 19.3.2018. |
| 115 | SUPERBETON - MATI (Pedonues Taulant Neça) | | | MEZEZ | 2679 | 60/92 | PALLAT | 3600 | | 3600 | | 27 | 177 | | | - | | | - | | | | 1,467,073.00 | | | | 1,467,073.00 | Seksioni D. Vendoset sekuestro konservative nga Zyra Përmbaruese "Debit Collection" sh.p.k., shkresa nr. 229 prot. nr. 221, reg. datë15.3.2018, protokolluar ZVRPP nr. 8320, datë 19.3.2018. |
| | | | | | | | | | | | | | | | | **142,345,397.69** | | | **601,324.00** | | **108,300.00** | **491,193.00** | **5,642,693.71** | | | **11,419,085.63** | **160,607,994.03** | |
| **Efekti financiar shtesë 96 881 119.30 lekë** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 52, datë 28.1.2026**

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 3204, FSHATI RRAKULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE SYNEJ, BASHKIA KAVAJË, QARKU TIRANË, NGA SHOQËRIA *"SELECT ENERGY"* SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në zonën kadastrale 3204, fshati Rrakull, Njësia Administrative Synej, Bashkia Kavajë, qarku Tiranë, nga shoqëria *"Select Energy"* sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria *"Select Energy"* sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: M22415014G;

c) Tipi i centralit: Fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 95 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në zonën kadastrale 3204, fshati Rrakull, njësia administrative Synej, Bashkia Kavajë, Qarku Tiranë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe plan-vendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqëria *"Select Energy"* sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj), pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet shoqërisë *"Select Energy"* sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2% të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria *"Select Energy"* sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

ANEKSI 1
KOORDINATAT E ZONËS SË PROJEKTIT

KOORDINATAT E CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE 3204, FSHATI RRAKULL, NJËSIA ADMINISTRATIVE SYNEJ, BASHKIA KAVAJË, QARKU TIRANË, NGA SHOQËRIA *"SELECT ENERGY"* SHPK

| KORDINATAT NE SISTEMIN KRGJSH | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NR | E | N | | NR | E | N | | NR | E | N |
| P1 | 458789 | 4563713.08 | | P5 | 459190.128 | 4562948.804 | | P9 | 457649.779 | 4562590.65 |
| P2 | 458951.76 | 4563701.46 | | P6 | 458835.51 | 4562646.4 | | P10 | 457533.106 | 4562750.258 |
| P3 | 459057.349 | 4563606.658 | | P7 | 458204.79 | 4562237.133 | | P11 | 458402.188 | 4563332.733 |
| P4 | 459147.577 | 4563380.863 | | P8 | 457726.68 | 4562647.451 | | P12 | 458473.435 | 4563243.506 |
| | | | | | | | | | | |

**Plan-vendosja e zonës së projektit**

**VENDIM**
**Nr. 54, datë 28.1.2026**

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 51/2025, "Për rezervat materiale të shtetit", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (në vijim, DPRMSH) si person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit, me seli në Tiranë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit financohet nga buxheti i shtetit, nga donacione të ndryshme, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Buxheti i DPRMSH-së përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit.

3. DPRMSH-ja ka si mision ndërhyrjen në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë dhe të ekonomisë në situata të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, çrregullimit të tregut, të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore, mjedisin, si dhe dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

1. DPRMSH-ja e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet në dy nivele:

a) në nivel qendror, si drejtori e përgjithshme;

b) në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale.

2. DPRMSH-ja përgjigjet për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë administrative të drejtorive rajonale.

3. DPRMSH-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për rezervat materiale të shtetit. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson DPRMSH-në në marrëdhëniet me të tretët.

4. Drejtoritë rajonale janë struktura në varësi të DPRMSH-së, nën drejtimin e drejtorit rajonal dhe zbatojnë detyrat e ngarkuara për mundësimin e ndërhyrjes operacionale në nivel vendor e rajonal, që mbulon drejtoria rajonale, apo dhe kombëtar, në raste të shpalljes së gjendjes së luftës, të sulmeve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore.

5. Drejtoritë rajonale drejtohen, mbikëqyren dhe përfaqësohen nga drejtori i institucionit, i cili i raporton drejtorit të përgjithshëm të DPRMSH-së për realizimin e objektivave të përcaktuar dhe të detyrave të ngarkuara.

6. Drejtori i drejtorisë rajonale emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra, sipas legjislacionit për shërbimin civil.

7. DPRMSH-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare.

8. Stema e DPRMSH-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, ministria përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit", në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

9. Drejtoritë rajonale kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare.

10. Stema e drejtorive rajonale përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, ministria përgjegjëse për rezervat materiale të shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit (emri i degës territoriale)", në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

11. Vula e DPRMSH-së dhe vulat e drejtorive rajonale kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, admini-

strimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare". Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. DETYRAT E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT DHE TË DREJTORIVE RAJONALE

1. DPRMSH-ja, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

a) Identifikon e vlerëson nevojën për hartimin ose ndryshimin e legjislacionit, lidhur me mirëmenaxhimin e rezervës materiale të shtetit;

b) Harton projektbuxhetin për realizimin e detyrave të DPRMSH-së, bën detajimin e buxhetit, si dhe monitoron përdorimin e fondeve përkundrejt planifikimit;

c) Bashkëpunon e koordinon me institucionet dhe strukturat përkatëse qendrore e vendore për lehtësimin e procedurave doganore dhe të kalimit të kufirit, në rastet e marrjes e të dhënies së ndihmave humanitare;

ç) Organizon trajnime të personelit, që do të ngarkohet me ngritjen e strukturave akomoduese të DPRMSH-së në vendet e përcaktuara për akomodim të kategorisë së popullsisë në nevojë;

d) Bashkëpunon me institucionet dhe strukturat në nivel qendror e vendor apo me institucionet e specializuara, lidhur me hartimin e planeve operacionale, me qëllim përfshirjen dhe mirëpërcaktimin e detyrimeve të rezervës materiale të shtetit;

dh) Bashkëpunon me institucionet drejtuese të strukturave të posaçme apo të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin e situatave të gjendjes së luftës, të akteve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, të fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si pasojë e këtyre të dyjave, si dhe të çrregullimit të tregut, me qëllim garantimin e operacionalitetit të rezervës materiale të shtetit, në rast pamundësie teknike apo problemesh të tjera të mundshme, që mund të dalin gjatë ndërhyrjeve operacionale;

e) Bashkëpunon me institucionet e nivelit qendror apo dhe të tjera të përcaktuara me ligj në funksione koordinuese, për të garantuar dhënien e ndihmës humanitare vendeve të huaja, sipas legjislacionit përkatës dhe normave të së drejtës ndërkombëtare;

ë) Planifikon, organizon e shpërndan mallrat rezervë shteti për mbrojtjen e popullsisë dhe të ekonomisë, të pasurisë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit në situata të gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, të veprimeve terroriste, të çrregullimit të tregut, të cilat sjellin pasoja dhe dëme të mëdha për njerëzit, gjënë e gjallë dhe mjedisin;

f) Mban në gatishmëri dhe miradministron mallrat rezervë shteti;

g) Përdor kapacitetet operacionale, në mbështetje të operacioneve luftarake dhe joluftarake, të emergjencave civile në nivel vendor, rajonal e kombëtar, si dhe në mbështetje të ekonomisë, në rastet e çrregullimit të tregut;

gj) Jep ndihmë humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare, si dhe të planeve strategjike të institucionit;

h) Menaxhon e administron rezervat materiale të shtetit, në përputhje me planin strategjik afatmesëm dhe atë vjetor;

i) Planifikon plotësimin e rezervave materiale të shtetit, sipas nevojave dhe risqeve të parashikuara për ndërhyrjen operative në mbrojtje të popullsisë dhe të ekonomisë, gjatë situatave të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, çrregullimit të tregut, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisit, si dhe dhënien e ndihmave humanitare;

j) Organizon punën për garantimin në kohë të ndërhyrjeve operacionale të rezervës materiale të shtetit në situatat e gjendjes së luftës, të akteve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si dhe të çrregullimit të tregut;

k) Bashkëvepron me strukturat menaxhuese, planifikuese apo koordinuese të situatave të gjendjes së luftës, akteve terroriste, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore, fatkeqësive të tjera, emergjencave civile, si dhe të çrregullimit të tregut, në zbatim të vendimeve së tyre;

l) Garanton menaxhimin e mirëfunksionimin e rezervës materiale të shtetit, në çdo situatë, nëpërmjet zëvendësimit, freskimit, mirëmbajtjes, këmbimit, dhurimit e shitjes së rezervave materiale të shtetit.

2. Drejtoritë rajonale të rezervave materiale të shtetit kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:

a) Zbatojnë drejtimet strategjike dhe objektivat e përcaktuar nga DPRMSH-ja, lidhur me zëvendë-

simin, freskimin, mirëmbajtjen, këmbimin, dhurimin dhe shitjen e rezervave materiale të shtetit;

b) Menaxhojnë dhe administrojnë rezervat materiale të shtetit në përgjegjësi të tyre, në përputhje me planin strategjik afatmesëm dhe atë vjetor;

c) Planifikojnë nevojat e tyre për plotësim me mallra rezervë materiale të shtetit, për të siguruar gatishmërinë operative në mbrojtje të popullsisë dhe ekonomisë, gjatë situatave të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësisë natyrore e fatkeqësive të tjera, veprimeve terroriste, çrregullimit të tregut, gjësë së gjallë, pasurisë, trashëgimisë kulturore, mjedisit, si dhe dhënien e ndihmave humanitare;

ç) Zbatojnë drejtimet strategjike lidhur me garantimin në kohë të ndërhyrjeve operacionale të rezervës materiale të shtetit në situatat e gjendjes së luftës, të akteve terroriste, të gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, të fatkeqësive të tjera, të emergjencave civile, si dhe të çrregullimit të tregut;

d) Koordinojnë veprimtarinë në nivel vendor e rajonal me drejtuesit e pushtetit vendor menaxhues të situatave të emergjencave civile vendore e rajonale për ofrimin e ndërhyrjes operacionale të rezervës materiale të shtetit, sipas detyrave të ngarkuara nga DPRMSH-ja.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në momentin e miratimit të strukturës dhe të organikës të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, DPRMSH-ja vijon funksionimin e saj sipas strukturës dhe organikës aktuale në fuqi.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rezervat materiale të shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 56, datë 28.1.2026**

## PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE "REGJISTRI QENDROR I BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (KADASTRA FISKALE)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazën e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Objekti i këtij vendimi është:

a) krijimi i bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale)" dhe përcaktimi i autoritetit përgjegjës për administrimin e saj;

b) përcaktimi i të dhënave të nevojshme për administrimin e taksës mbi ndërtesën, si dhe i rregullave për mbledhjen e menaxhimin e tyre.

KREU II
REGJISTRI QENDROR I BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (KADASTRA FISKALE)

Neni 2
**Krijimi dhe administrimi i Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale)**

1. Për qëllimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe miradministrimit të taksës mbi ndërtesën, krijohet baza e të dhënave shtetërore "Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale)".

2. Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) krijohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë

(në vijim DPTP), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit përkatës.

3. Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) administrohet nga DPTP-ja.

KREU III
TË DHËNAT QË PËRMBAN REGJISTRI QENDROR I BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (KADASTRA FISKALE)

Neni 3
**Të dhënat që përmban Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale)**

1. Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) përmban të dhëna për:

a) ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave;

b) pronarët, zhvilluesit dhe përdoruesit e njësive të ndërtesave, në funksion të përcaktimit të përgjegjësisë tatimore, detyrimeve tatimore dhe përjashtimeve nga taksa;

c) zonat e vlerave, duke përfshirë kufijtë gjeografikë, identifikuesit unikë dhe çmimet referuese për secilën prej tyre;

ç) kufijtë gjeografikë dhe identifikuesit unikë (numrat) të parcelave;

d) kufijtë gjeografikë dhe identifikuesit unikë (numrat) të zonave dhe blloqeve kadastrale;

dh) kufijtë administrativë, emrat dhe numrat e bashkive, dhe njësive administrative brenda tyre;

e) bazën e taksës (vlerën e taksueshme) për njësitë e ndërtesave;

ë) shkallët e zbatueshme të taksës për:

i. njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për banim;

ii. njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike;

iii. ndërtesat e papërfunduara;

f) kamatëvonesat dhe gjobat e zbatueshme;

g) detyrimet tatimore, afatet për pagesë dhe pagesat e bëra për përmbushjen e tyre;

gj) rimbursimet e kryera për detyrime tatimore të paguara më tepër;

h) faktorët e prezumuar, që përdoren për përcaktimin e bazës së taksës dhe shkallës së taksës, në rastet kur mungojnë të dhënat e nevojshme;

i) të dhëna të tjera të nevojshme për administrimin e taksës për ndërtesën, si dhe informacionin për përdoruesit e sistemit informatik të Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale).

Neni 4
**Të dhënat për ndërtesën dhe njësinë e ndërtesës**

1. Të dhënat për ndërtesën përfshijnë:

a) identifikuesin unik teknik që ka ndërtesa në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

b) emrin e bashkisë ku ndodhet ndërtesa;

c) emrin e qytetit dhe emrin/numrin e njësisë administrative ku ndodhet ndërtesa;

ç) identifikuesin unik të zonës kadastrale ku ndodhet ndërtesa;

d) identifikuesin unik të zonës së vlerës ku ndodhet ndërtesa;

dh) identifikuesin unik të parcelës ku ndodhet ndërtesa;

e) kufirin gjeografik të ndërtesës (poligoni i gjurmës) ose koordinatat *GPS* të ndërtesave, pa kufij të përcaktuar;

ë) adresën e ndërtesës;

f) numrin e përgjithshëm të kateve të ndërtesës (ku specifikohen numri i kateve mbi dhe nën sipërfaqen e tokës);

g) llojin e ndërtesës (ndërtesë me një njësi ndërtese ose me shumë njësi ndërtese);

gj) të dhënat për lejen e ndërtimit dhe për pronën, të parashikuara në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*).

2. Të dhënat për njësinë e ndërtesës përfshijnë:

a) identifikuesin unik teknik që ka njësia e ndërtesës në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

b) numrin e pasurisë që ka njësia e ndërtesës në regjistrin kadastral;

c) adresën e njësisë së ndërtesës;

ç) katin ku ndodhet njësia e ndërtesës (e zbatueshme për ndërtesat me shumë njësi);

d) sipërfaqen e njësisë së ndërtesës në metra katrorë;

dh) kategorinë e ndërtesës;

e) kategorinë e vlerës;

ë) shfrytëzimin e njësisë së ndërtesës (informacion më i detajuar, kur është i disponueshëm për mënyrën e përdorimit të njësive të ndërtesave, që janë pjesë e kategorive të gjera të vlerës, të tilla, si kategoria e vlerës, ndërtesa që shërbejnë për tregti dhe shërbime, siç janë hotelet, restorantet, dyqanet);

f) çmimin referues që ka zona e vlerës, ku ndodhet njësia e ndërtesës;

g) statusin e privatizimit, nëse njësia e ndërtesës është banesë (banesë e privatizuar ose banesë e paprivatizuar);

gj) statusin e ndërtimit (ndërtesë e përfunduar ose e ndërtesë e papërfunduar);

h) statusin e dëmtimit të njësisë së ndërtesës (e dëmtuar apo e padëmtuar nga forcë madhore);

i) vlerën e taksueshme (bazën e taksës) të njësisë së ndërtesës;

j) shkallën e zbatueshme të taksës;

k) taksën e llogaritur për njësinë e ndërtesës;

l) vitin tatimor;

ll) të dhëna për detyrime të tjera tatimore (taksa të papaguara nga vitet paraardhëse tatimore, gjoba dhe kamatëvonesa), të lidhura me njësinë e ndërtesës;

m) përjashtimin ose jo nga taksa të njësisë së ndërtesës dhe arsyen e përjashtimit, nëse njësia përjashtohet;

n) lehtësimin/përjashtimin e pjesshëm nga detyrimi për pagimin e taksës, si dhe kohëzgjatjen e tij, në rastet e zbatimit të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Neni 5

**Të dhënat për taksapaguesin**

1. Të dhënat për taksapaguesin përfshijnë:

a) identifikuesin unik teknik që ka taksapaguesi në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

b) për individët dhe personat fizikë:

i. numrin personal të identifikimit (për individët);

ii. emrin, atësinë dhe mbiemrin (për individët);

iii. gjininë (për individët);

iv. numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) dhe emrin e personit fizik (nëse për taksapaguesin individ nuk disponohen të dhënat e përcaktuara në nënndarjet "i" dhe "ii", të kësaj shkronje);

c) për personat juridikë:

i. numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

ii. emrin e personit juridik;

ç) adresën e taksapaguesit;

d) statusin juridik të taksapaguesit:

i. pronar;

ii. zhvillues;

iii. përdorues;

dh) pjesën takuese të taksapaguesit (pjesa takuese e njësisë së ndërtesës);

e) të dhënat për organizatat jofitimprurëse, të parashikuara në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse;

ë) të dhënat e aplikantit për leje ndërtimi, si subjekt tregtar, individ, institucion, të parashikuara në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*);

f) të dhënat për detyrimet tatimore të taksapaguesit;

g) të dhënat mbi pagesat e bëra për përmbushjen e detyrimeve tatimore;

gj) të dhënat për rimbursimet që i janë bërë taksapaguesit për detyrimet tatimore të paguara më tepër.

Neni 6

**Të dhënat parësore dhe të dhënat dytësore**

1. Të dhënat parësore përfshijnë:

a) identifikuesin unik teknik që ka ndërtesa në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

b) identifikuesin unik teknik që ka njësia e ndërtesës në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

c) identifikuesin unik teknik që ka taksapaguesi në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

ç) zonat e vlerave, duke përfshirë kufijtë gjeografikë, identifikuesit unikë dhe çmimet referuese për secilën prej tyre;

d) identifikuesin unik të zonës së vlerës ku ndodhet ndërtesa;

dh) bazën e taksës (vlerën e taksueshme) për njësitë e ndërtesave;

e) shkallët e zbatueshme të taksës për:

i. njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për banim;

ii. njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike;

iii. ndërtesat e papërfunduara;

ë) vitin tatimor;

f) përjashtimin ose jo nga taksa të njësisë së ndërtesës dhe arsyen e përjashtimit, nëse njësia përjashtohet;

g) lehtësimin/përjashtimin e pjesshëm nga detyrimi për pagimin e taksës, si dhe kohëzgjatjen e tij, në rastet e zbatimit të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar;

gj) kamatëvonesat dhe gjobat e zbatueshme;

h) detyrimet tatimore, afatet për pagesë dhe pagesat e bëra për përmbushjen e tyre;

i) të dhëna për detyrime të tjera tatimore (taksa të papaguara nga vitet paraardhëse tatimore, gjoba dhe kamatëvonesa), të lidhura me njësinë e ndërtesës;

j) rimbursimet e kryera për detyrime tatimore të paguara më tepër;

k) faktorët e prezumuar, që përdoren për përcaktimin e bazës së taksës dhe shkallës së taksës, në rastet kur mungojnë të dhënat e nevojshme;

l) të dhënat për detyrimet tatimore të taksapaguesit;

ll) të dhënat mbi pagesat e bëra për përmbushjen e detyrimeve tatimore;

m) të dhënat për rimbursimet që i janë bërë taksapaguesit për detyrimet tatimore të paguara më tepër;

n) statusin e dëmtimit të njësisë së ndërtesës (e dëmtuar apo e padëmtuar nga forcë madhore).

2. Të dhënat dytësore janë të dhëna që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore dhe me të cilat Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) ndërvepron dhe ato janë:

a) ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave;

b) pronarët, zhvilluesit dhe përdoruesit e njësive të ndërtesave, në funksion të përcaktimit të përgjegjësisë tatimore, detyrimeve tatimore dhe përjashtimeve nga taksa;

c) kufijtë gjeografikë dhe identifikuesit unikë (numrat) të parcelave;

ç) kufijtë gjeografikë dhe identifikuesit unikë (numrat) të zonave dhe blloqeve kadastrale;

d) kufijtë administrativë, emrat dhe numrat e bashkive dhe njësive administrative brenda tyre;

dh) emrin e bashkisë ku ndodhet ndërtesa;

e) emrin e qytetit dhe emrin/numrin e njësisë administrative ku ndodhet ndërtesa;

ë) kufirin gjeografik të ndërtesës (poligoni i gjurmës) ose koordinatat *GPS* të ndërtesave, pa kufij të përcaktuar;

f) adresën e ndërtesës dhe të njësisë së ndërtesës;

g) numrin e përgjithshëm të kateve të ndërtesës (ku specifikohen numri i kateve mbi dhe nën sipërfaqen e tokës), si dhe të katit ku ndodhet njësia e ndërtesës (e zbatueshme për ndërtesat me shumë njësi);

gj) llojin e ndërtesës (ndërtesë me një njësi ndërtese ose me shumë njësi ndërtese);

h) numrin e pasurisë që ka njësia e ndërtesës në regjistrin kadastral;

i) sipërfaqen e njësisë së ndërtesës në metra katrorë;

j) kategorinë e ndërtesës;

k) statusin e privatizimit, nëse njësia e ndërtesës është banesë (banesë e privatizuar ose banesë e paprivatizuar);

l) statusin e ndërtimit (ndërtesë e përfunduar ose e ndërtesë e papërfunduar);

ll) të dhënat për lejen e ndërtimit dhe për pronën, të parashikuara në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*);

m) për individët dhe personat fizikë:

i. numrin personal të identifikimit (për individët);

ii. emrin, atësinë dhe mbiemrin (për individët);

iii. gjininë (për individët);

iv. numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) dhe emrin e personit fizik (nëse për taksapaguesin individ nuk disponohen të dhënat e përcaktuara në nënndarjet "i" dhe "ii", të kësaj shkronje);

n) për personat juridikë:

i. numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

ii. emrin e personit juridik;

nj) adresën e taksapaguesit;

o) statusin juridik të taksapaguesit:

i. pronar;

ii. zhvillues;

iii. përdorues;

p) pjesën takuese të taksapaguesit (pjesa takuese e njësisë së ndërtesës);

q) të dhënat për organizatat jofitimprurëse, të parashikuara në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse;

r) të dhënat e aplikantit për leje ndërtimi, si subjekt tregtar, individ, institucion, të parashikuara në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*).

KREU IV
AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR MENAXHIMIN E TË DHËNAVE NË REGJISTRIN QENDROR TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (KADASTRA FISKALE) DHE PËRGJEGJËSITË PËRKATËSE

Neni 7
**Të drejtat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për menaxhimin e të dhënave**

1. Në ushtrim të detyrave të saj, në funksion të procesit të regjistrimit të të dhënave, DPTP-ja kryen veprimet e mëposhtme:

a) Regjistron dhe përditëson të dhënat për zonat e vlerave;

b) Regjistron dhe përditëson shkallët e zbatueshme të taksës për çdo bashki;

c) Regjistron dhe përditëson faktorët e prezumuar të përdorur për përcaktimin e bazës së taksës (vlerës së taksueshme) dhe shkallës së taksës, në funksion të llogaritjes së taksës mbi ndërtesën;

ç) Regjistron dhe përditëson të dhënat e përdoruesve të sistemit informatik të Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

d) Regjistron dhe përditëson normat e zbatueshme të kamatëvonesës dhe gjobës;

dh) Regjistron dhe përditëson afatet për pagesën e taksës mbi ndërtesën.

2. Përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, DPTP-ja kryen edhe përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Udhëheq, asiston e monitoron bashkitë në procesin e regjistrimit, përditësimit dhe korrigjimit të të dhënave në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

b) Pajis përdoruesit e sistemit informatik të Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) me kode hyrjeje dhe u vë në dispozicion kredencialet e përdoruesve (aksesit).

3. DTPT-ja është dhënësja e vetme e të dhënave që përmban Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale).

Neni 8
**Të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkisë për menaxhimin e të dhënave**

Në ushtrim të detyrave të saj, në funksion të procesit të regjistrimit të të dhënave për administrimin e taksave mbi njësitë e ndërtesave brenda territorit të saj, bashkia:

a) regjistron të dhënat e regjistruara në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

b) korrigjon, në përputhje me vendimet administrative ose vendimet gjyqësore të formës së prerë, të dhënat përkatëse në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale);

c) korrigjon, në përputhje me rekomandimin e DPTP-së apo me iniciativën e saj, të dhënat përkatëse, pas konstatimit të pasaktësive.

KREU V
NDËRVEPRIMI ME BAZAT E TJERA TË TË DHËNAVE DHE BASHKËPUNIMI ME DHËNËSIT E INFORMACIONIT

Neni 9
**Ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave**

1. Regjistri Qendror i Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) ndërvepron nëpërmjet platformës së ndërveprimit me bazat e mëposhtme të të dhënave:

a) Regjistrin e pasurive të paluajtshme, në administrim të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;

b) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;

c) Regjistrin Kombëtar të Adresave, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;

ç) Regjistrin Tregtar, në administrim të Qendrës Kombëtare të Biznesit;

d) Gjeoportalin Kombëtar, në administrim të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor;

dh) Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndihmës Ekonomike, në administrim të Shërbimit Social Shtetëror;

e) Regjistrin e Sigurimeve Shoqërore dhe Pensioneve, në administrim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

ë) Regjistrin e klientëve, në administrimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

f) Sistemin elektronik të tatimeve (*E-TAX*), në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

g) Sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*), në administrim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit;

gj) Regjistrin elektronik të organizatave jofitim-prurëse, në administrim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

KREU VI
NIVELI I AKSESIMIT TË REGJISTRIT QENDROR TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (KADASTRA FISKALE)

Neni 10
**Niveli i aksesimit të Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë**

1. DPTP-ja, në cilësinë e institucionit administrues, ka të drejtë leximi dhe kontrolli mbi të gjitha të dhënat e regjistruara në Regjistrin Qendror të Bazës së Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale), si dhe të drejta hedhjeje ose modifikimi mbi të dhënat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 7, të kreut IV, të këtij vendimi.

2. DPTP-ja ka të drejtën e hedhjes dhe modifikimit edhe mbi të dhënat e përcaktuara në nenin 11, të këtij kreu, me kusht që këto të drejta të ushtrohen në bazë të një kërkese dhe autorizimi paraprak nga bashkia përkatëse e të dokumentohen në mënyrë të rregullt. DPTP-ja ushtron të drejtën për të hedhur dhe për të modifikuar të dhënat e përcaktuara në nenin 11, të këtij kreu, në kuadër të rolit të saj mbështetës/asistues dhe vetëm në ato raste, kur bashkia, për arsye problemesh teknike, të dokumentuara saktësisht, nuk mund të bëjë hedhjen ose modifikimin e të dhënave të përcaktuara në nenin 11, të këtij kreu, në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale).

Neni 11
**Niveli i aksesimit të Regjistrit Qendror të Bazës së Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) nga bashkia**

Bashkia ka të drejta leximi, hedhjeje ose modifikimi vetëm mbi të dhënat e regjistruara në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) për pasuritë e paluajtshme që ndodhen në territorin e saj, taksapaguesit, detyrimet përkatëse tatimore dhe të dhëna të tjera të ndërlidhura, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1, të nenit 7, të kreut IV, të këtij vendimi, për të cilat bashkia ushtron të drejtën e leximit dhe jo të drejtën e hedhjes ose modifikimit për të dhënat e veta.

Neni 12
**Niveli i aksesimit të Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) nga autoritetet publike**

Autoritetet publike të përmendura në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, kanë të drejta leximi dhe përdorimi mbi të dhënat e regjistruara në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale), si përdoruese të këtij regjistri e të konsultojnë të dhënat e këtij regjistri, si dhe të printojnë ekstrakte.

Neni 13
**Gjurma e auditit për veprimet e përdoruesve në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale)**

Të gjitha veprimet e përdoruesve në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale) regjistrohen si gjurmë auditi për të siguruar se të dhënat lexohen vetëm për qëllime të përmbushjes së detyrave funksionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT DHE SHFUQIZIME

Neni 14
**Dispozita të fundit**

1. Bashkitë kanë detyrimin të administrojnë taksën mbi ndërtesën në Regjistrin Qendror të Bazës së të Dhënave të Pasurive të Paluajtshme (Kadastra fiskale), duke filluar nga data 10 shkurt 2026.

2. Vendimi nr. 273, datë 16.5.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Regjistrit Qendror të Bazës së të Dhënave për Llogaritjen e Taksës Vendore të Pasurisë së Paluajtshme "ndërtesë" (Kadastra fiskale)", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, bashkitë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Qendra Kombëtare e Biznesit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe institucionet e përcaktuara në shtojcën nr. 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Shtojca nr. 1**

LISTA E AUTORITETEVE PUBLIKE QË KANË TË DREJTËN E AKSESIMIT DHE TË PËRDORIMIT TË TË DHËNAVE NË REGJISTRIN QENDROR TË BAZËS SË TË DHËNAVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (KADASTRA FISKALE)

1. Ministritë;
2. Gjykatat e çdo niveli;
3. Prokuroritë e çdo niveli;
4. Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
5. Byroja Kombëtare e Hetimit;
6. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
7. Institucionet përgjegjëse për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
8. Institucionet përgjegjëse për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme, sipas ligjit nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme";
9. Organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
10. Agjencia e Inteligjencës Financiare;
11. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
12. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara;
13. Avokatura e Shtetit;
14. Avokati i Popullit;
15. Shërbimi Social Shtetëror.

**VENDIM**
**Nr. 58, datë 28.1.2026**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË *"INNOVATION4ALBANIA"***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 9/1, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", të ndryshuar, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton organizimin dhe funksionimin e agjencisë "*Innovation4Albania*", në vijim Agjencia, si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për inovacionin, me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit, donacione dhe burime të tjera të ligjshme. Buxheti i

Agjencisë përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për inovacionin.

3. Agjencia ka si mision të kontribuojë, të nxisë dhe të promovojë inovacionin dhe angazhimin në administratën publike të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë në implementimin e teknologjive të përparuara, përmes hartimit dhe zbatimit të politikave në bashkëpunim me ministritë e linjës në fushat dhe sektorët përkatës lidhur me inovacionin, si dhe të sigurojë mirëfunksionimin e ekosistemit të *startup*-eve në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet mbështetjes dhe zhvillimit të tij.

4. Agjencia për realizimin e misionit të saj bashkëpunon me organizma vendas dhe ndërkombëtarë me fushë të ngjashme veprimtarie, me qëllim përthithjen e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e zhvillimit të inovacionit dhe *startup*-eve.

5. Agjencia organizon dhe koordinon iniciativa, programe dhe aktivitete në nivel sektorial, kombëtar apo rajonal, që mundësojnë realizimin e misionit të saj, si dhe nxit bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve të ekosistemit për zhvillimin e aktiviteteve të inovacionit dhe përdorimin e teknologjisë.

II. FUNKSIONIMI I AGJENCISË

1. Agjencia ka këto përgjegjësi funksionale:

a) Në bashkëpunim me ministritë e linjës, agjenci apo ente publike, zhvillon dhe implementon iniciativa, programe, projekte dhe politika në fushën e inovacionit;

b) Identifikon koncepte novatore, procese dhe teknika të reja për inovimin e shërbimeve publike dhe të administratës publike;

c) Asiston ministritë, agjencitë apo entet publike me njohuri të veçanta dhe ekspertizë për identifikimin e problematikave komplekse dhe propozimin e zgjidhjeve sistematike e inovatore;

ç) Merr pjesë në përgatitjen e akteve rregullatore, ligjore e nënligjore, për zhvillimin e fushave të inovacionit, si dhe jep mendim të detyrueshëm për institucionet publike për hapjen dhe funksionimin e entiteteve që operojnë në fushën e inovacionit, me qëllim zbatimin efektiv të politikave, projekteve dhe iniciativave në këto fusha;

d) Përmes iniciativave të ndryshme nxit dhe u propozon ministrive të linjës, agjencive apo enteve publike modernizimin e shërbimeve të administratës publike dhe përfshirjen e ekspertëve më të mirë në administratën publike;

dh) Menaxhon dhe monitoron realizimin e masave mbështetëse financiare nëpërmjet fondeve publike ose të tretëve për nismat ne ekosistemin e *startup*-eve në Republikën e Shqipërisë;

e) Vetë, ose, kur është rasti, në bashkëpunim me institucione të tjera publike ofron shërbimin *startup one stop-shop* për mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve;

ë) Organizon punën për promovimin në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të nismave në ekosistemin e *startu*p-eve të Republikës së Shqipërisë;

f) Organizon punën në cilësinë e organit mbështetës për *startup*-et dhe lehtësuesit, duke bashkëpunuar me palët e treta, me synim tërheqjen dhe mbështetjen e financimeve nga donatorë të huaj për ekosistemin e *startup*-eve në Shqipëri.

2. Agjencia, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

a) Promovon inovacionin, proceset dhe teknikat e reja për inovimin e shërbimeve publike dhe të administratës publike;

b) Harton plane veprimi për zbatimin e politikave në fushën e inovacionit dhe mbështetjes së ekosistemit të *startup*-eve;

c) Mbështet dhe bashkërendon punën për projektet dhe iniciativat e institucioneve në nivel kombëtar në fushën e inovacionit dhe *startup*-eve;

ç) Lidh marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione, organizata dhe organizma të tjerë, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e misionit të saj;

d) Administron "Regjistrin e *startup*-eve dhe lehtësuesve" dhe në bashkëpunim me AKSHI-n;

dh) Ndjek mirëfunksionimin e aplikimeve për pasaportat e *startup*-eve dhe lehtësuesve;

e) Asiston subjektet e interesuara përgjatë procesit të aplikimit për pasaportën e *startup*-it;

ë) Informon subjektet për mundësitë e mbështetjes qeveritare apo për skemat e mbështetjes në ekosistemin e *startup*-eve;

f) Administron dhe përditëson portalin elektronik zyrtar: startupalbania.gov.al;

g) Si sekretariat teknik asiston dhe informon Këshillin e *Startup*-eve, me kërkesë të kryetarit të Këshillit, për tematika të nevojshme dhe në kuadër të hartimit të dokumenteve strategjike;

gj) Shërben si sekretariat teknik për komisionet që ngrihen në funksion të vlerësimit të kërkesave

dhe ankesave për masat mbështetëse për nismat në ekosistemin e *startup*-eve;

h) Lidh marrëveshje dhe monitoron zbatimin e tyre me përfituesit e granteve financiare, programeve dhe masave mbështetëse sipas legjislacionit në fuqi;

i) Shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin justifikues dhe financiar, në funksion të ecurisë së zbatimit të masave mbështetëse;

j) Kryen disbursimin e fondit për realizimin e projekteve sipas legjislacionit përkatës;

k) Në raste abuzimi ose mospërmbushjeje detyrimesh të parashikuara në marrëveshje, ndërmerr veprimet ligjore për rikthimin e fondit të disbursuar;

l) Angazhohet në hartimin dhe përgatitjen e aplikimeve, si dhe përthithjen e fondeve, me qëllim zhvillimin e inovacionit dhe ekosistemit vendas të *startup*-eve;

ll) Organizon dhe promovon evente ose forume specifike, të fokusuara te shkëmbimi i ek-speriencave, këshillimi, mentorimi dhe rrjetëzimi për zhvillimin e inovacionit dhe ekosistemit të *startup*-eve;

m) Favorizon bashkëpunimin e aktorëve të ekosistemit të inovacionit dhe të *startup*-eve me organet publike, përfaqësuesit e biznesit dhe botën akademike, si dhe palë të treta të tjera, me qëllim krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për zhvillimin e inovacionit dhe krijimin e një tregu funksional për *startup*-et;

n) Mbledh, përpunon dhe analizon informacionin për kushtet, nevojat, kapacitetet e *startup*- eve dhe lehtësuesve, si dhe dinamikat e tendencat e tregut e të ekosistemit të *startup*-eve;

nj) I propozon ministrit përgjegjës për inovacionin nevojat për masat mbështetëse për ekosistemin e *startup*-eve, në kuadër të planifikimit për vitin pasardhës;

o) Përgatit dhe publikon raportin vjetor për ecurinë e funksionimit të "Regjistrit të *startup*-eve dhe lehtësuesve";

p) Përgatit dhe publikon raportin vjetor mbi gjendjen dhe ecurinë e ekosistemit shqiptar të *startup*-eve, si në nivel kombëtar ashtu edhe në krahasim me tregjet dhe ekosistemet ndër-kombëtare;

q) Përgatit raporte dhe informacion përmbledhës mbi çështjet e inovacionit, në varësi të problematikave të evidentuara, si dhe raporte të tjera periodike, sipas kërkesës, mbi ecurinë e ekosistemit vendas të *startup*-eve;

r) Raporton çdo 6 muaj para Këshillit të Ministrave mbi ecurinë e punës dhe rezultatet e ciklit të inovacionit të hapur, të parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, duke paraqitur problematikat e evidentuara, zgjidhjet e mundshme dhe rekomandimet për vendimmarrjen e mëtejshme;

rr) Kryen çdo detyrë tjetër në fushën e inovacionit apo *startup*-eve, të caktuar nga ministri përgjegjës për inovacionin, Këshilli i Ministrave apo legjislacioni në fuqi.

3. Pjesë e Agjencisë janë edhe "Njësitë e inovacionit", në funksion të ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore, të cilat kanë objekt kryesor të veprimtarisë së tyre:

a) identifikimin e koncepteve, proceseve novatore dhe teknikave të reja, në përputhje me politikat e ministrisë apo institucionit qendror;

b) kryerjen e studimeve dhe analizave krahasuese mbi politikat në nivel rajonal e ndërkombëtar;

c) analizimin e të dhënave, në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave të ndërmarra nga ministria apo institucioni qendror, me qëllim zhvillimin e analizave strategjike për të zbuluar mundësi të reja inovacioni;

ç) propozimin dhe menaxhimin e projekteve apo iniciativave zhvillimore në fushat përkatëse;

d) kontribuimin me njohuri dhe ekspertizë të posaçme të nevojshme për një periudhë të caktuar kohore në fushën që mbulon institucioni dhe për të cilën mungojnë kapacitetet e nevojshme në institucion.

4. Agjencia nëpërmjet "Njësive të inovacionit", të përcaktuara në pikën 3, të këtij kreu, zbaton ciklin e "Inovacionit të hapur", i cili përfshin:

a) identifikimin dhe përcaktimin e problemeve e të sfidave të propozuara nga ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe përcaktimin e zgjidhjeve të mundshme;

b) hartimin, zhvillimin dhe administrimin e sfidave të tipit *GovTech*, ekspozimin e tyre ndaj aktorëve të ndryshëm publikë dhe privatë, si dhe konsolidimin e koncepteve të testuara në dokumente zyrtare, të shoqëruara me treguesit përkatës të performancës (KPI);

c) organizimin dhe zbatimin e projekteve pilot ose të aktiviteteve testuese, përmes mekanizmave si akseleratorë, *sandbox-e* apo forma të tjera të ngjashme të bashkëpunimit me aktorët e ekosistemit, me

qëllim verifikimin dhe testimin e zgjidhjeve të propozuara;

ç) mbledhjen e të dhënave, analizimin e rezultateve dhe përgatitjen e dokumentit përfundimtar me rekomandimet përkatëse për zgjidhje me karakter inovativ.

5. Pranë Agjencisë ngrihet Këshilli i Inovacionit, si forum këshillimor dhe bashkërendues, me qëllim mbledhjen, dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ekosistemit të inovacionit, përfshirë institucionet publike, lehtësuesit e ekosistemit, institucionet akademike, sektorin privat, donatorët dhe aktorë të tjerë relevantë. Këshilli ka natyrë këshillimore dhe bashkërenduese, pa të drejtë shpërblimi dhe pa mbështetje buxhetore. Agjencia shërben si sekretariat teknik i Këshillit dhe kujdeset për organizimin e mbledhjeve. Rregullat e hollësishme për përbërjen e Këshillit, kriteret, procedurën e përzgjedhjes, kompetencat dhe organizimin e funksionimin përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për inovacionin.

6. Agjencia ndihmon ministrin përgjegjës për inovacionin në ushtrimin e detyrave.

III. ORGANIZIMI I AGJENCISË

1. Agjencia e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili përgjigjet para ministrit përgjegjës për inovacionin dhe përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët.

3. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga ministri përgjegjës për inovacionin.

4. Drejtori i përgjithshëm organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Agjencisë. Ai ngre grupe pune me ekspertë për kryerjen e detyrave specifike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga një zëvendësdrejtor.

5. Drejtori i përgjithshëm duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë shtetas shqiptar apo i huaj, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt;

b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) Të ketë diplomë të nivelit "Master shkencor" apo "Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike", ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkenca sociale, inxhinierike, juridike, ekonomike apo të tjera, të lidhura me inovacionin dhe ekosistemin e *startup*-eve;

ç) Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në pozicione drejtuese;

d) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

dh) Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

6. Drejtori i përgjithshëm lirohet nga detyra kur:

a) plotëson kushtet për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

c) ristrukturohet apo mbyllet institucioni;

ç) gjendet në një situatë konflikti të vazhdueshëm interesi;

d) jep dorëheqjen nga detyra.

7. Drejtori i përgjithshëm shkarkohet nga detyra, kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

b) kryen shkelje të rënda gjatë detyrës;

c) nuk përmbush objektivat strategjikë të institucionit;

ç) ka performancë të dobët në ushtrimin e detyrës.

8. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm dhe punonjësve të Agjencisë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

9. Struktura dhe organika e Agjencisë hartohen në përputhje me përgjegjësitë funksionale të parashikuara në këtë vendim dhe miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në Agjenci realizohet nëpërmjet procedurave konkurruese me shpallje publike, në përputhje me kriteret e përcaktuara në përshkrimet e punës.

11. Agjencitë dhe institucionet kërkimore në varësi të ministrive të linjës, si dhe institucionet e

tjera të administratës shtetërore koordinojnë aktivitetin e tyre me Agjencinë sa i përket çështjeve që lidhen me inovacionin.

12. Institucionet e tjera që mbështesin me masa mbështetëse inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe digjitalizimin, sipas kërkesës, i përcjellin informacion Agjencisë për subjektet e mbështetura në funksion të koordinimit në tërësi.

13. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e saj përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë", "Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit", Agjencia "*Innovation4Albania*", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

14. Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë emërohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

3. Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e dedikuara për inovacionin dhe monitorimin në Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës dhe numri i punonjësve, asetet, dhe fondet e dedikuara për Agjencinë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve kalojnë pranë agjencisë "*Innovation4Alba*nia", në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor. Shpenzimet për këto çështje kryhen nga institucionet në të cilat ndodhen aktualisht.

4. Punonjësit aktualë të Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës dhe punonjësit e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve transferohen pranë agjencisë "*Innovation4Albania*" dhe trajtohen në bazë të legjislacionit në fuqi për ristrukturimin e institucionit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe fillojnë nga momenti i emërimit të punonjësve në detyrë.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 467, datë 26.7.2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve", dhe nr. 620, datë 1.11.2023, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës", të ndryshuar, shfuqizohen.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Agjencia "*Innovation4Albania*", Departamenti i Administratës Publike, si dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë vendim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 59, datë 28.1.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT E FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalët "Znj. Elsa Dhuli ..." zëvendësohen me "Znj. Lantona Sado ...";

b) Fjalët "Z. Arbjan Mazniku ..." zëvendësohen me "Z. Ervin Demo ...";

c) Fjalët "Znj. Mimoza Kaçi ..." zëvendësohen me "Znj. Adela Xhemali ...";

ç) Nënndarja "- Z. Sofjan Jaupaj, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, negociator për kapitullin 27;" zëvendësohet me "- Z. Sofjan Jaupaj, ministër i Mjedisit, negociator përgjegjës për kapitullin 27;";

d) Nënndarja "- Znj. Orjana Osmani, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, negociator për kapitullin 26;" zëvendësohet me "Znj. Orjana Osmani, zëvendësministër i Arsimit, negociator përgjegjës për kapitullin 26;";

dh) Nënndarja "- Znj. Denada Seferi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 dhe 28;" zëvendësohet me "- Znj. Denada Seferi, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 dhe 28;";

e) Nënndarja "- Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 2 dhe 3, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19;" zëvendësohet me "- Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 2 dhe 3, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19;";

ë) Nënndarja "- Znj. Blerta Rama, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 6 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4;" zëvendësohet me "- Znj. Blerta Rama, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 6 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4;";

f) Nënndarja "- Z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm dhe negociator përgjegjës për kapitullin 24" zëvendësohet me "- Znj. Silva Caka, zëvendësministër i Punëve të Brendshme dhe negociator përgjegjës për kapitullin 24;";

g) Nënndarja "- Znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, negociator përgjegjës për kapitullin 25" zëvendësohet me "- Znj. Armela Baka, zëvendësministër i Arsimit, negociator përgjegjës për kapitullin 25;";

gj) Nënndarja "- Z. Sokol Duma, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 7 e 20;" zëvendësohet me "- Z. Martin Kajo, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitujt 7 e 20;";

h) Nënndarja "- Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 30;" shfuqizohet;

i) Në fund të nënndarjes "- Znj. Megi Fino, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, negociator përgjegjës për kapitullin 31 ..." shtohen fjalët "... dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 30;";

j) Nënndarja "- Z. Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 1 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 28 e 30;" zëvendësohet me "- Z. Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit, negociator përgjegjës për kapitullin 1 dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 28 dhe 30;";

k) Nënndarja "- Znj. Erjona Çela, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kriteret ekonomike dhe kapitullin 33;" shfuqizohet.

l) Në fund të nënndarjes "- Z. Andi Memeti, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kapitullin 32 ..." shtohen fjalët "... dhe kapitullin 33;";

ll) Nënndarja "- Z. Florian Semani, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kapitujt 16 dhe 29;" zëvendësohet me "- Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër i Financave, negociator përgjegjës për kriterin ekonomik, kapitujt 16 dhe 29;";

m) Nënndarja "- Z. Arian Jaupllari, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitujt 11 dhe 12;" zëvendësohet

me "- Z. Arian Jaupllari, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator përgjegjës për kapitullin 12;";

n) Nënndarja "- Z. Roland Kristo, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator për kapitullin 13;" zëvendësohet me "- Z. Fatmir Guri, zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, negociator përgjegjës për kapitujt 11 dhe 13;".

2. Ngarkohen grupi negociator i Republikës së Shqipërisë dhe institucionet, sipas pikës 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 60, datë 28.1.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 649, DATË 16.10.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT'", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit'", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 3, emërtesa "Ministria e Turizmit dhe Mjedisit" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për turizmin";

2. Në tekstin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Emërtesa "Ministria e Turizmit dhe Mjedisit" zëvendësohet me fjalët "ministria përgjegjëse për turizmin";

b) Fjalët "detit/liqenit" zëvendësohen me "detit/liqenit/lumit";

c) Pas shkronjës "d", të pikës 2, të nenit 2, shtohet shkronja "d/1", me këtë përmbajtje:

"d/1) Plazh publik i tarifuar nga NJVV-ja", zona e plazheve të lejuara në dispozicion të pushuesve, të administruara dhe të tarifuara nga NJVV-ja ose ente të krijuara prej tyre, që ofrojnë kërkesa minimale për sigurinë dhe higjienën. Në këtë tipologji plazhi ndalohet kontraktimi apo delegimi i stacionit të plazhit nga NJVV-ja tek subjektet private.";

ç) Në nenin 4 bëhen shtesat dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

i. Pas shkronjës "ç", të pikës 1, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) hapësirat e plazhit publik të tarifuar nga NJVV-ja;";

ii. Në fund të pikës 2 shtohen fjalët "... , si dhe me agjencitë rajonale të bregdetit.";

iii. Në pikën 3, pas fjalëve "... privat/publik ..." shtohen fjalët"... /publik i tarifuar nga NJVV-ja ...";

d) Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë:

i. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik (në vijim, KMST) kryesohet nga ministri përgjegjës për turizmin dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të nivelit të lartë nga:

a) ministria përgjegjëse për shëndetësinë;

b) ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë;

c) ministria përgjegjëse për mbrojtjen;

ç) ministria përgjegjëse për punët e brendshme;

d) ministria përgjegjëse për ekonominë;

dh) ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

e) ministri përgjegjës për pushtetin vendor,

dhe asistohet nga Task-Forca Ndërinstitucionale e Sezonit Turistik, e ngritur me urdhër të Kryeministrit.";

ii. Në shkronjën "a", të pikës 4, fjalët "... si dhe plazheve publike ..." zëvendësohen me "... plazheve publike, si dhe plazheve publike të tarifuara nga NJVV-ja ...";

dh) Në nenin 6 bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Në fund të shkronjës "a", të pikës 1, shtohen fjalët "..., si dhe të plazheve publike të tarifuara nga NJVV-ja;...";

ii. Në fund të shkronjës "dh", të pikës 1, shtohen fjalët "... dhe të agjencive rajonale të bregdetit.";

iii. Në fjalinë e parë, të pikës 2, pas togfjalëshit "... plazhe publike ..." shtohen fjalët "... , si dhe plazhe publike të tarifuara nga NJVV-ja ...".

e) Pas nenit 6 shtohet neni 6/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 6/1

1. Këshilli bashkiak, përpara fillimit të çdo sezoni turistik, mund të miratojë me vendim çmimet maksimale për secilën zonë bregdetare në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të cilat shërbejnë si kufi maksimal për negocimin dhe zbatimin e çmimeve nga subjektet private.

Në mungesë të këtij vendimi, çmimi maksimal përcaktohet ndërmjet bashkisë dhe subjektit privat, në përputhje me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe interesit publik.

2. Çmimet maksimale përcaktohen në mënyrë të diferencuar sipas zonave, duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit turistik, aksesueshmërinë, intensitetin e kërkesës, standardin e shërbimit dhe interesin publik.

3. Çmimet maksimale të dakordësuara bëhen pjesë përbërëse dhe detyruese e kontratës së nënshkruar ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe subjektit privat e nuk mund të tejkalohen gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

4. Tejkalimi i çmimeve maksimale përbën shkelje kontraktore dhe shkak për vendosjen e masave administrative dhe/ose zgjidhjen e kontratës.";

ë) Në nenin 7 bëhen shtesat dhe ndryshimi, si më poshtë:

i. Në fund të pikës 2, shtohen fjalët dhe fjalia "... dhe ka përparësi mbi kontratat e plazhit të lidhura në atë zonë. Në çdo rast, gëzimi i përdorimit të bregut të detit si stacion plazhi nga investitori strategjik fillon pas vënies në funksion të strukturës akomoduese turistike.";

ii. Në pikën 4, pas shkurtesës "... GTSHA-ja ..." shtohen fjalët "... që kryesohet nga titullari i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit ...";

iii. Në pikën 9, togfjalëshi "... brenda datës 31 mars, ..." hiqet;

f) Kudo në nenin 9, pas togfjalëshit "... plazhe publike ..." shtohen fjalët "... si dhe plazhe publike të tarifuara nga NJVV-ja ...", sipas kuptimit të fjalisë;

g) Në pikën 4, të nenit 11, pas togfjalëshit "... plazhit publik ..." shtohen fjalët "... , si dhe plazheve publike të tarifuara nga NJVV-ja ...";

gj) Neni 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 12

**Respektimi i kushtit për nivelin e lejuar të zhurmave**

1. Çdo stacion plazhi është i detyruar të respektojë nivelin kufi të zhurmave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për zhurmat, si dhe/ose në planet vendore të miratuara nga organet e vetëqeverisjes vendore.

2. Njësia e vetëqeverisjes vendore, para fillimit të sezonit turistik veror, publikon planin e detajuar vendor mbi nivelin e zhurmave për secilin plazh, i detyruar për zbatim për secilin subjekt në zonën bregujore.

3. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, si dhe agjencitë rajonale të bregdetit raportojnë çdo ankesë/raportim të paraqitur pranë saj në Policinë e Shtetit, në Policinë Bashkiake, në NJVV-në, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si dhe në çdo institucion tjetër kompetent për monitorimin e nivelit të zhurmave.";

h) Në nenin 14 bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë:

i. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Përjashtimisht, për Bashkinë Fier, Bashkinë Divjakë, Bashkinë Pogradec, për plazhin Zvërnec, Plazhi i Vjetër, Bashkia Vlorë, plazhet Spille, Vilë-Bashtovë, Bashkia Rrogozhinë, plazhet Shetaj, plazhi i Gjirit të Lalzit, plazhi Hamallaj, plazhi i Katundit të Ri, plazhi Porto-Romano 1, plazhi Currila 1, plazhi Currila 2, plazhi Currila 3, plazhi Currila 4, plazhi Currila 5, Bashkia Durrës, plazhet Borsh, Llaman, plazhi Lukovë 2, plazhi Maraçi, Bashkia Himarë, plazhi i Rrjollit, Bashkia Shkodër, në stacionet e plazhit, që nuk ka struktura akomoduese pranë apo në afërsi të hapësirës së plazhit, nuk zbatohet kriteri i parashikuar në

shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 7, dhe subjekti, përveç kritereve të parashikuara në shkronjat "c" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 7, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të jetë i regjistruar si person fizik apo juridik për ushtrimin e veprimtarisë, si strukturë shërbimi;

b) Të disponojë një strukturë shërbimi dhe të ketë hapësirë plazhi pranë strukturës së shërbimit.

4. Subjektet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, paraqesin kërkesën për aplikim pranë portalit "*e-Albania*", së bashku me dokumentacionin, që vërteton plotësimin e kritereve të parashikuara në këtë rregullore. GTSHA-ja është përgjegjëse për sigurimin e ekstraktit të regjistrimit, sipas shkronjës "a", të pikës 3, të këtij neni. Numri maksimal i çadrave, që vendosen në stacionin e plazhit pranë strukturës së shërbimit, është 50 (pesëdhjetë).";

ii. Pas pikës 6, shtohen pikat 7 dhe 8, me këtë përmbajtje:

"7. Subjekti që disponon një strukturë akomoduese të marrë me qira, në rast zgjidhjeje të saj, ka detyrimin për njoftimin e menjëhershëm të AKB-së dhe përbën shkak për zgjidhjen e kontratës.

8. Për kontratat e lidhura me subjektet private për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, njësia e vetëqeverisjes vendore mund të negociojë me subjektin privat çmimet maksimale, që do të aplikohen për shërbimin e çadrave dhe të shezlongëve, në përputhje me karakteristikat specifike të zonës bregujore përkatëse.";

i) Në nenin 3, të shtojcës I, "Kontrata model për përdorimin e hapësirës së plazhit", që i bashkëlidhet rregullores, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

i. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet "Kohëzgjatja dhe çmimi maksimal";

ii. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Çmimi maksimal i dakordësuar është _____. Ky çmim nuk mund të tejkalohet gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate.".

II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit, Drejtoria e Përgjithshme Detare, strukturat përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

**ÇËSHTJA TASHI KUNDËR SHQIPËRISË**
*(kërkesa nr. 1351/19)*

VENDIM

STRASBURG
13 janar 2026

*Ky vendim është i formës së prerë, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.*

**Në çështjen Tashi kundër Shqipërisë**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare,*
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendësekretare e Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 1351/19) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë, më 28 dhjetor 202018, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shtetase shqiptare, znj. Evgjeni Tashi ("kërkuesja"), lindur në vitin 1959, me banim në Tiranë dhe e përfaqësuar nga z. E. Rusi, avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën Qeverinë Shqiptare ("Qeveria") e përfaqësuar z. O Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 2 dhjetor 2025,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në vitin 1966, babai i kërkueses bleu një shtëpi dhe ndërtoi një mur rreth saj.

2. Më 27 qershor 2008, Inspektorati i Ndërtimit dhe Planifikimit Urban ("Inspektorati i Ndërtimit") urdhëroi shembjen e murit me arsyetimin se ishte ndërtim i paligjshëm. Shembja e murit ndodhi në vitin 2008.

3. Më 12 mars 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi padinë e babait të kërkueses ndaj Inspektoratit të Ndërtimit. Ajo vlerësoi se muri nuk kishte qenë ndërtim i paligjshëm, prishi vendimin për shembjen e tij, dhe e detyroi Inspektoratin e Ndërtimit të rindërtonte murin 14.3 m të gjatë dhe 1.8 m të lartë. Më 10 maj 2011, Gjykata e Apelit e la në fuqi atë vendim. Në qershor 2011, u lëshua një urdhër ekzekutimi.

4. Më 1 korrik 2011, babai i kërkueses nisi procedurat përmbarimore me anë të një përmbaruesi.

5. Më 22 korrik 2011, përmbaruesi theksoi në raportin e tij zyrtar se muri do të ndërtohej nga babai i kërkueses nën mbikëqyrjen e tij, si pjesë e procedurave përmbarimore të vendimit të vitit 2011.

6. Më 7 nëntor 2011, përmbaruesi kërkoi që Inspektorati i Ndërtimit të rimbursonte shpenzimet e bëra nga babai i kërkueses për rindërtimin e murit. Autoritetet Shtetërore nuk kanë nisur ndonjë proces ndaj masave të përmbaruesit apo të babait të kërkueses.

7. Më 5 shkurt 2015, babai i kërkueses ndërroi jetë dhe kërkuesja vijoi procesin e brendshëm në vend të si një prej tre trashëgimtarëve të tij.

8. Më 26 shkurt 2015, Gjykata e Lartë la në fuqi pjesërisht vendimin e Gjykatës së Rrethit 2010 në lidhje me prishjen e vendimit të Inspektoratit të Ndërtimit, dhe e ndryshoi atë pjesërisht duke i akorduar dëm pasuror babait të kërkueses në vend që t'i urdhëronte autoritetet të rindërtonin murin.

9. Më 8 mars 2017, kërkuesja nisi procesin për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

10. Më 2 tetor 2018, kërkuesja dhe trashëgimtarët e tjerë u gjobitën nga Inspektorati Kombëtar i Ndërtimit dhe Planifikimit Urban ("Inspektorati Kombëtar i Ndërtimit") me argumentin se muri me gjatësi 36 m ishte ndërtim i paligjshëm, dhe u lëshua një vendim për shembjen e tij. Shembja e tij ndodhi më 17 tetor 2018.

11. Më 26 dhjetor 2018, Gjykata Administrative Tiranë pranoi kërkesën e kërkueses për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shembja e murit në vitin 2018. Procesi vijon ende pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Më 6 korrik 2022, autoritete Shtetërore ekzekutuan vendimin e Gjykatës së Lartë, duke paguar kompensimin pasuror dhe më 28 shkurt 2023, autoritete paguan kostot dhe shpenzimet për procedurat e përmbarimit.

13. Në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe nenit 13 të Konventës, si edhe në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuesja u ankua se ishte shkelur parimi i sigurisë juridike dhe e drejta e saj ndaj pronës, sepse vendimi i vitit 2015 dhënë në favor të babait të saj nuk ishte ekzekutuar, dhe muri ishte prishur për herë të dytë.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

14. Parashikimet përkatëse në lidhje me mjetin kompensues për kohëzgjatjen e procesit përcaktohen te *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* (nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 37, 12 tetor 2021) dhe *ARB sh.p.k. dhe të Tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 39860/19 dhe 2 të tjerë, §§ 65-76, 27 maj 2025).

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

**A. Siguria juridike**

15. Kërkuesja u ankua në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës se shembja e dytë e murit rrethues në shtëpinë e babait të saj kishte shkelur parimin e sigurisë juridike.

*1. Pranueshmëria*

16. Qeveria parashtroi se ankesa ishte e parakohshme duke qenë se procesi i kompensimit për shembjen e dytë të murit ishte ende pezull.

17. Gjykata vëren se ankesa e kërkueses ka lidhje me shkeljen e parimit të sigurisë juridike për ligjshmërinë e murit të shembur, sipas një vendimi të formës së prerë, dhe jo për kompensimin për shembjen e dytë të murit, që është ende duke u shqyrtuar pranë gjykatave të brendshme (shih paragrafin 11 më sipër). Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se kjo ankesë nuk është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës, apo e papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

*2. Meritat*

18. Kërkuesja argumentoi se ligjshmëria e murit ishte konfirmuar në grupin e parë të procedurave, dhe rindërtimi i murit në vitin 2011 ishte bërë nën mbikëqyrjen e përmbaruesit dhe mbështetur në vendimin e Gjykatës së Apelit, që ishte i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Masat e përmbaruesit nuk u kundërshtuan asnjëherë nga autoritetet Shtetërore.

19. Qeveria argumentoi se autoritetet e brendshme kishin vepruar në përputhje me

parashikimet ligjore. Muret e prishur në vitin 2008 dhe 2018 nuk ishin të njëjtë. Muri i dytë ishte 36 m në krahasim me murin e parë që ishte 14.3 m, dhe për këtë arsye, nuk ishte shkelur parimi i sigurisë juridike.

20. Gjykata vëren se e drejta për t'u dëgjuar pranë një gjykate e garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës duhet të interpretohet sipas Preambulës së Konventës, ku midis të tjerash përcaktohet se shteti i së drejtës është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një prej aspekteve themelore të shtetit të së drejtës është parimi i sigurisë juridike, i cili parashikon, ndër të tjera se në rastin kur gjykatat kanë marrë një vendim të formës së prerë për një çështje, vendimmarrja e tyre nuk duhet të dihet në dyshim (shih *BrumÎrescu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28342/95, § 61, GJEDNJ 1999-VII; *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, §§ 51-56, GJEDNJ 2003-IX; dhe *Ro'ca kundër Moldavisë*, nr. 6267/02, § 24, 22 mars 2005). Gjykata përsërit se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate, e garantuar nga neni 6 § 1, do të ishte e gënjeshtërt nëse sistemi juridik i një Shteti Kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor, detyrues, i formës së prerë të mbetej jofunksional në dëm të njërës palë (shih *Stoyanov dhe Tabakov kundër Bullgarisë (nr. 2),* nr. 64387/14, § 51, 7 dhjetor 2021, me referenca të tjera).

21. Për sa i përket çështjes konkrete, në fund të grupit të parë të procedurave, gjykatat e brendshme arritën në përfundimin se muri rrethues i shtëpisë së babait të kërkueses kishte qenë ndërtim i ligjshëm. Muri i dytë u ndërtua për të zëvendësuar të parin nën mbikëqyrjen e përmbaruesit gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit të vitit 2015 (shih paragrafët 4–6 më sipër). Gjykata vlerëson se autoritetet vendase nuk i kundërshtuan masat e përmbaruesit dhe as nuk nisën ndonjë procedurë në lidhje me ndërtimin ose përmasat e murit të ri. Qeveria nuk parashtroi se raporti përmbarimor i hartuar nga përmbaruesi në vitin 2011, apo kërkesa e përmbaruesit për shlyerjen e shpenzimeve, të ishin kundërshtuar pranë gjykatave të brendshme dhe as nuk paraqiti ndonjë argument se kishte arsye për ta bërë këtë. Pavarësisht nga sa më sipër, Inspektorati Kombëtar i Ndërtimi, pas më shumë se dhjetë vjetësh nga rindërtimi, arriti në përfundimin se muri ishte ndërtim i paligjshëm dhe e shembi atë (shih paragrafin 10 më sipër). Sidoqoftë, muri i rindërtuar u shemb i gjithi, duke përfshirë pjesën që ishte deklaruar e ligjshme nga gjykatat.

22. Këto fakte tregojnë se, me shembjen e murit për herë të dytë, autoritetet administrative nuk respektuan vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 26 shkurt 2015 që konfirmonte se muri ishte ndërtim i ligjshëm. Masat e Autoriteteve Shtetërore e kanë lënë kërkuesen në një gjendje pasigurie të vazhdueshme dhe e kanë bërë të pamundur ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhënë në favor të saj.

23. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se shembja e dytë e murit rrethues së shtëpisë së babait të kërkueses vuri në dyshim vendimin e formës së prerë të dhënë në grupin e parë të procesit, dhe gjykon se përbën një shkelje të parimit të sigurisë juridike të parashikuar në nenin 6 § 1 të Konventës.

**B. Kohëzgjatja e procesit të përmbarimit**

24. Kërkuesja u ankua për mosekzekutim ose ekzekutim të vonuar të vendimit të vitit 2015 dhënë në favor të saj.

25. Qeveria parashtroi se në vitin 2023, vendimi rezultonte të ishte i ekzekutuar. Për sa ka të bëjë me ekzekutimin e vonuar, Qeveria argumentoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit kërkesën për njohjen e kohëzgjatjes së tepër të procedurave, mbështetur në nenin 399/6 të Kodit të Procedurës Civile (shih referencën në paragrafin 14 më sipër), dhe, në vijim, kërkesën për dëmshpërblim të drejtë. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, në këtë mënyrë kërkuesja nuk kishte shfrytëzuar mjetet vendase.

26. Gjykata mban në konsideratë faktin se autoritetet iu deshën shtatë vite të ekzekutonin vendimin e vitit 2015 (shih paragrafët 12 më sipër) dhe se ata nuk bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për ta zbatuar atë vendim në kohën e duhur. Megjithatë, mbështetur në nenin 399/6 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesja duhej të kishte paraqitur një kërkesë për njohjen e kohëzgjatjes së tepërt të procesit pranë Gjykatës së Rrethit. Në parim, Gjykata e vlerëson efikas mjetin kompensues për kohëzgjatjen e tepër të procesit (shih *Bara dhe Kola*, §§ 110-18, dhe *ARB SHPK dhe të Tjerë*, §192, të dy cituar më sipër). Kërkuesja nuk e ka shfrytëzuar këtë mjet. Për këtë arsye, ankesa në lidhje me kohëzgjatjen e mosekzekutimit duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshterim të mjeteve të brendshme.

II. ANKESA TË TJERA

27. Ankuesja u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës për mungesën e pretenduar të mjetit efektiv dhe për shkeljen e së drejtës së saj ndaj pasurisë, në lidhje me ankesën për mosekzekutimin e vendimit të brendshëm të formës së prerë.

28. Për sa u përket fakteve të çështjes, parashtrimeve të palëve dhe gjetjeve të saj, Gjykata vlerëson se ajo ka shqyrtuar çështjet kryesore juridike të ngritura në çështjen konkrete. Në këtë mënyrë, ajo konstaton se nuk është e nevojshme të jepet një vendim i veçantë për këto ankesa (shih *Qendra për Burimet Juridike në emër të Valentin Cmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

ZBATIM I NENIT 41 TË KONVENTËS

29. Në parashtrimet e saj, kërkuesja kërkoi dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror pa përcaktuar ndonjë shumë. Megjithatë, në kërkesën e saj pranë Gjykatës, ajo kishte kërkuar 620,800 lekë shqiptar (ALL) për dëmin pasuror për kostot e rindërtimit dhe për çdo dëm tjetër, dhe 10,000 euro (EUR) për dëmin jopasuror. Kërkuesja nuk kishte bërë kërkesë për kostot dhe shpenzimet.

30. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa si të pajustifikuara dhe argumentoi se kërkuesja nuk kishte formuluar një kërkesë për dëmshpërblim të drejtë.

31. Nën rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vëren se është e vërtetë se kërkuesja kërkonte shuma specifike për dëmin pasuror dhe jopasuror, vetëm në formularin e kërkesës. Megjithatë, në vërejtjet e saj parashtruar brenda afatit përkatës, ku u ftua shprehimisht të formulonte kërkesat e saj për dëmshpërblim të drejtë, kërkuesja e shprehu qartazi kërkesën për dëm pasuror dhe jopasuror, pavarësisht se nuk e përcaktonte shumën. Për këtë arsye, nuk mund të thuhet se ajo nuk parashtroi kërkesa për justifikim të drejtë brenda afatit përkatës në përputhje me rregullin 60, ku theksohet se dëmi jopasuror nuk e mundëson përllogaritjen precize dhe se një kërkesë e tillë nuk është gjithmonë e nevojshme të përcaktohet nga kërkuesit (shih *Svrtan kundër Kroacisë*, nr. 57507/19, § 105, 3 dhjetor 2024.)

32. Duke u kthyer tek kërkesa për dëmin pasuror, Gjykata vëren se kërkuesja ka marrë kompensimin përkatës të dhënë nga gjykatat e brendshme për koston e rindërtimit. Për këtë arsye, ajo e rrëzon këtë kërkesë. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se kërkuesja duhet të ketë vuajtur edhe dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së konstatuar. Duke bërë këtë vlerësim mbi baza të barabarta, siç kërkohet në nenin 41 të Konventës, ajo i akordon kërkueses 3,600 euro për dëmin jopasuror.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME, GJYKATA:

*1. E shpall* të pranueshme ankesën bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa ka të bëjë me parimin për sigurinë juridike dhe ankesën për kohëzgjatjen e procesit të papranueshme;

*2. Gjykon* se është shkelur parimi i sigurisë juridike sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shembjen nga autoritetet e brendshme të murit rrethues të shtëpisë së babait të kërkueses në vitin 2018;

*3. Gjykon* se nuk është e nevojshme që pranueshmëria ose meritat e ankesave të kërkueses sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 dhe nenit 13 të Konventës të shqyrtohen të ndara;

*4. Gjykon:*

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkueses, brenda tre muajve, 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për dëmin jopasuror, të konvertuar në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në shlyerje interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barabartë me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindjeje;

*5. Rrëzon* pjesën e mbetur të kërkesës së kërkueses për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 13 janar 2026, në mbështetje të rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Úna Ní Raifeartaigh**
KRYETARE

**Olga Chernishova**
ZËVENDËSSEKRETARE

**VENDIM**
**Nr. 70, datë 6.11.2025**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Holta Zaçaj | kryetare; |
| Marsida Xhaferllari | anëtare; |
| Fiona Papajorgji | anëtare; |
| Sonila Bejtja | anëtare; |
| Sandër Beci | anëtar; |
| Ilir Toska | anëtar; |
| Marjana Semini | anëtare; |
| Genti Ibrahimi | anëtar, |

me sekretare Anjeza Puka, në datën 6.11.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 18 (B) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bledar Bedini *alias* Imami, përfaqësuar nga avokat Ardian Visha.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokuror Arqilea Koça, me autorizim.

OBJEKTI: Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatë së Lartë.

Refuzimi i ekstradimit të shtetasit Bledar Bedini *alias* Imami nga Republika e Shqipërisë drejt Republikës së Italisë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka lënë në fuqi vendimin për lejimin e ekstradimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Bledar Bedini *(kërkuesi)*, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar pushimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

**I**
**Rrethanat e çështjes**

1. Me vendimin penal nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali, shtetasi shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami është deklaruar fajtor për veprën penale "Trafikimi i lëndëve narkotike", të parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal italian dhe nenet 73 e 74 të ligjit italian "Për drogën". Ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane të drejtësisë, mbi bazën e urdhrit për burgosje nr. 57/2009 SIEP, datë 21.9.2009 të Prokurorisë së Përgjithshme të Milanos, Itali, për ekzekutimin e pjesës së mbetur të dënimit prej 7 vjetësh burgim.

2. Fillimisht, në vitin 2015 autoritetet italiane të drejtësisë kanë kërkuar njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit të lartpërmendur penal të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos, Itali ndaj shtetasit shqiptar Bledar Bedini *alias* Imami. Bazuar në këtë kërkesë, në datën 22.10.2015 ndaj kërkuesit është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg". Paraburgimi i kërkuesit ka vijuar deri në datën 26.10.2016 kur Gjykata e Lartë ka zëvendësuar masën e sigurimit me atë të "Detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore", duke urdhëruar lirimin e tij.

3. Në datën 29.12.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur njohjen e vendimit penal të huaj, duke caktuar ndaj kërkuesit një dënim prej 7 vjetësh burgim. Pas gjykimit disa herë të çështjes nga gjykatat më të larta, në rigjykimin e fundit të saj Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 9.7.2019, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar kërkesën e prokurorit për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të huaj për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit sipas legjislacionit të brendshëm (shqiptar), referuar nenit 54 të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale", të ndryshuar *(ligji nr. 10193/2009)*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar

rekurs prokurori dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 30.9.2019.

4. Ndërkohë, në datën 15.2.2022 oficeri i Policisë Gjyqësore ka kryer përsëri arrestimin e përkohshëm të kërkuesit, tashmë për qëllime ekstradimi në shtetin italian, bazuar në urdhrin e burgosjes nr. SIEP 57/2009, datë 21.9.2009 të Prokurorisë së Përgjithshme të Milanos, Itali. Edhe në këtë rast ndaj kërkuesit është caktuar dhe zbatuar masa e sigurimit personal "Arresti në burg".

5. Në vijim, me kërkesën me Ref: EA 126 (2015) AR, datë 7.3.2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë ka kërkuar ekstradimin e kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim të dhënë me vendimin nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali. Në kërkesë janë parashtruar të dhënat për veprën penale për të cilën është dënuar ky shtetas, cilësimi ligjor i veprës dhe të dhëna rreth vendit dhe kohës së kryerjes së saj (gjatë periudhës 2000-2001). Kërkesa është mbështetur në rregullat e përcaktuara në Konventën Evropiane të Ekstradimit (*KEE*), si dhe në Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e së njëjtës konventë dhe e Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, nënshkruar në Tiranë në datën 3.12.2007 *(Marrëveshja e Ekstradimit)*. Sipas kërkesës, sistemi juridik italian parashikon se dënimi me burgim parashkruhet me kalimin e një kohe të barabartë me dyfishin e dënimit të dhënë, por, gjithsesi, jo më të madhe se 30 vjet dhe jo më të vogël se 10 vjet.

6. Kërkesën për ekstradim të autoriteteve italiane të drejtësisë, në datën 17.3.2022, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ia ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ia ka dërguar atë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, në datën 18.3.2022, ka paraqitur kërkesë për miratimin e lejimit të ekstradimit të kërkuesit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 375 akti, datë 14.9.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke miratuar lejimin e ekstradimit të kërkuesit në drejtim të Republikës së Italisë. Në thelb, gjykata ka arsyetuar se në kushtet kur Republika e Shqipërisë ka ratifikuar KEE-në, sipas së cilës ekstradimi i një shtetasi lejohet në qoftë se dënimi nuk është parashkruar sipas ligjit të shtetit kërkues, duke qenë se dënimi i kërkuesit nuk rezulton të jetë parashkruar sipas ligjit italian, ai (ekstradimi) duhet të lejohet. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1242, datë 20.12.2022, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëruar lirimin e kërkuesit nga paraburgimi. Ajo i ka vlerësuar si të bazuara pretendimet e kërkuesit për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit sipas ligjit shqiptar, cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të kërkesave të përsëritura (referuar kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj), si dhe për mosdhënien e garancisë nga shteti italian për rishikimin e vendimit penal të huaj, në kushtet kur gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Sipas gjykatës së apelit, dënimi me burgim sipas vendimit penal të huaj, për të cilin kërkohet ekstradimi, është parashkruar dhe, bazuar në parimin e reciprocitetit, shteti shqiptar nuk mund të pranojë ekstradimin e shtetasve të vet në të njëjtat kushte për veprat penale që ka juridiksion. Për sa kohë Italia e ka ratifikuar me rezervë paragrafin 2 të nenit 10 të KEE-së (ndryshuar me protokollin e katërt shtesë), zbatohet parimi i reciprocitetit dhe ajo nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite të k nga një shtet tjetër kontraktues. Për pasojë, duke mos qenë e zbatueshme norma konventore thirret për zbatim ligji i brendshëm, konkretisht neni 491, shkronja "ë", i Kodit të Procedurës Penale *(KPP),* sipas të cilit parashkrimi i dënimit sipas ligjit të shtetit të kërkuar përbën kusht ndalues për ekstradimin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokurori, me pretendimin se gjykata e apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit, duke parashtruar edhe nevojën për unifikim të praktikës gjyqësore në kushtet e mungesës së harmonizimit mes parashikimeve të KEE-së (nenit 10, paragrafi 2) dhe dispozitave të KPP-së (nenit 491, shkronja "ë").

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur nisjen e procedurës së gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet: (i) nëse zbatohet nga gjykata parimi i reciprocitetit në marrëdhëniet juridiksionale me një shtet, i cili ka vendosur rezervë ligjore mbi normën ndërkombëtare për moszbatimin e saj për çështjet që janë në juridiksionin e atij shteti; (ii) nëse gjykata duhet të lejojë ekstradimin e shtetasve shqiptarë, në rast se ndjekja penale ose dënimi është parashkruar

sipas ligjit shqiptar, drejt një shteti që për shkak të rezervës mbi normën ndërkombëtare refuzon ekstradimin e shtetasve të tij në rrethana analoge kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të atij shteti, për çështje që janë në juridiksionin e tij. Gjatë shqyrtimit, me vendimin e datës 26.10.2023, ai kolegj ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes, duke i kërkuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* të kontrollojë pajtueshmërinë me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës të shkronjës "ë" të nenit 491 të KPP-së, e cila nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Mbledhja e Gjyqtarëve, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, me vendimin nr. 46, datë 12.3.2024, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar çështjen dhe në përfundim, me vendimin nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin ishte lejuar ekstradimi i kërkuesit në Republikën e Italisë. Ai kolegj ka mbajtur qëndrimin njësues se gjykata lejon ekstradimin e shtetasve shqiptarë edhe kur ndjekja penale dhe dënimi janë parashkruar sipas ligjit penal shqiptar, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës, duke zbatuar nenin 10, paragrafi 2, të KEE-së, të ndryshuar me protokollin e katërt shtesë të kësaj konvente, edhe në rastet kur një shtet palë ka vendosur rezervë ndaj kësaj norme ndërkombëtare. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i është njoftuar mbrojtësit të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 23.10.2024.

10. Ndërkohë, me aktin nr. 2234/2 prot./A.H., datë 14.6.2024, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ekstradimin e kërkuesit për në Republikën e Italisë. Nisur nga fakti se kërkuesi nuk ndodhej i burgosur, është kërkuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Interpolit, marrja e masave për arrestimin e tij, me qëllim dorëzimin tek autoritetet italiane.

11. Në datën 24.12.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është lejuar ekstradimi i tij për në Republikën e Italisë, si dhe refuzimin e ekstradimit. Kjo kërkesë, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 31.12.2024. Në vijim, në datën 11.3.2025, kërkuesi ka plotësuar ankimin me pretendime shtesë, duke kërkuar edhe pezullimin e vendimit të kundërshtuar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Gjykata, me pretendimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është vendim i formës së prerë dhe në zbatim të tij autoritetet shqiptare do të vijonin me ekstradimin e tij, ndaj, në këto kushte, gjykimi i pritshëm kushtetues do të zhvishej nga qëllimi dhe roli i tij dhe nuk do të mund të rivendoste në vend të drejtat e shkelura atij.

12. Kolegji i Gjykatës në datën 12.3.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 18.3.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për pezullimin e vendimit nr. 00-2024-1611 (125), datë 22.5.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi për shkak të qëndrimeve të ndryshme, nuk u arrit numri i kërkuar i votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës. Sipas njërit qëndrim, duke qenë se vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt kërkimi, ka vendosur përfundimisht lejimin e ekstradimit të kërkuesit në drejtim të Republikës së Italisë dhe ky vendim mund të ekzekutohet përpara përfundimit të gjykimit në Gjykatë, kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë duhet të pranohet[1]. Sipas qëndrimit tjetër, duke qenë se ndaj kërkuesit nuk po zbatohet asnjë masë sigurimi personal dhe nuk ka një datë të përcaktuar për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkesa për pezullimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk duhet të pranohet[2].

13. Ndërkohë, në datën 16.6.2025 kërkuesi është arrestuar me qëllim ekstradimin e tij, dorëzimin tek autoritetet italiane, sipas aktit miratues të ekstradimit të ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë. Në vijim, me kërkesën e kërkuesit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm

[1] Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Genti Ibrahimi.

[2] Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Ilir Toska dhe Marjana Semini.

Tiranë, me vendimin nr. 969 akti, datë 26.6.2025, ka vendosur lirimin e tij të menjëhershëm nga paraburgimi, me arsyetimin se Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë në datën 23.6.2025 ka revokuar aktin miratues të ekstradimit për arsye se autoritetet italiane në datën 10.3.2025 kanë revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit, në kushtet kur gjykata italiane në datën 11.9.2024 kishte vendosur shuarjen e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian.

14. Në rrethanat si më lart *(shih paragrafin 13 të vendimit),* në çështjen me objekt njohjen e vendimit penal të huaj *(shih paragrafin 3 të vendimit),* Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1183, datë 15.7.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorit, për shkak të heqjes dorë prej tij.

## II
## Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, në kërkesën fillestare dhe atë shtesë, ka parashtruar se vendimi i Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit cenon:

15.1. *Parimin e mosgjykimit dy herë,* sipas nenit 34 të Kushtetutës *(të parashtruar në ankimin kushtetues të datës 24.12.2024)*, për shkak se gjykatat kanë shqyrtuar dhe gjykuar dy kërkesa (njohjen e vendimit të huaj dhe lejimin e ekstradimit) për të njëjtin fakt, ndaj një shtetasi shqiptar, me të njëjtin shtet kërkues. Gjykata e Lartë për të njëjtin fakt që kishte refuzuar njohjen e vendimit dhe ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë, lejoi ekstradimin në kundërshtim me parimet kushtetuese.

15.2. *Parimin e ligjshmërisë,* për shkak se, pavarësisht parashikimeve të nenit 10, paragrafi 2, të KEE-së, sipas të cilit ekstradimi i shtetasve ndalohet vetëm në rastet kur vepra penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar në bazë të legjislacionit të palës kërkuese (dhe jo më edhe të asaj të kërkuar), në kushtet kur Italia ka vendosur rezervë ndaj parashikimit të këtij neni, në respekt të parimit të reciprocitetit, gjykata në rastin e kërkuesit do të duhej të zbatonte nenin 491, shkronja "ë", të KPP-së, i cili nuk lejon ekstradimin kur ndjekja penale ose dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar. Po ashtu, lejimi i ekstradimit nga Gjykata e Lartë është bërë në kushtet e mungesës së garancisë rishikuese të parashikuar në nenin 491, shkronja "f", të KKP-së, sipas të cilit ekstradimi nuk mund të jepet kur personi i kërkuar është dënuar në mungesë, me përjashtim të rastit kur shteti kërkues jep garanci për rishikimin e vendimit.

15.3. *Parimin e sovranitetit të shtetit (të parashtruar në ankimin kushtetues shtesë të datës 11.3.2025),* në kushtet kur lejimi i ekstradimit ka zhveshur shtetin shqiptar nga mbrojtja e shtetasve të tij në një situatë kur nuk ka një detyrim për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare referuar zbatimit të nenit 10 të protokollit të katërt shtesë të KEE-së.

15.4. *Parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve,* për shkak se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë, duke i njohur ministrit të Drejtësisë të drejtën të vlerësojë zbatimin e parimit të reciprocitetit, ka zhveshur gjykatat nga kompetenca për të vlerësuar zbatimin e kritereve dhe kushteve të ekstradimit, në kundërshtim me nenin 39 të Kushtetutës. Po ashtu, ky interpretim i ligjit nga Gjykata e Lartë e ka bërë të paqartë zbatimin e nenit 10 të protokollit të katërt shtesë të KEE-së, në shkelje të *parimit të sigurisë juridike*, duke lënë shteg për interpretime dhe zbatim të ndryshëm të tij, në kundërshtim edhe me *parimin e barazisë para ligjit.*

15.5. *Parimin e hierarkisë së akteve ligjore,* për shkak të vlerësimit të gabuar të zbatimit ose jo të detyrimeve që rrjedhin nga KEE-ja dhe nga parimi i reciprocitetit.

15.6. *Parimin e zbatimit të normës penale favorizuese,* për shkak se në mungesë të një detyrimi për zbatimin e KEE-së nisur nga rezerva e bërë nga shteti italian, neni 419, shkronja "ë", i KPP-së dhe dispozitat penale shqiptare janë normat juridike të zbatueshme dhe më të favorshme në rastin e kërkuesit, duke pasur parasysh se ato nuk lejojnë ekstradimin kur dënimi është parashkruar sipas ligjit të shtetit të kërkuar, i cili parashikon afate më të ulëta për parashkrimin në raport me ato sipas legjislacionit italian.

15.7. *Lirinë personale,* për shkak se ajo është kufizuar pa ligj dhe në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, ndërsa për shkak të procesit të ekstradimit është mbajtur në paraburgim për një periudhë tejet të gjatë, deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë.

16. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme,*** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se pas depozitimit nga kërkuesi të kërkesës në Gjykatë, Republika e Italisë ka revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit, ndërsa në

datën 11.3.2025 Ministria e saj e Drejtësisë i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë shkresën Ref: EA 126 (2015) AR, datë 10.3.2025, bashkë me njoftimin për urdhrin N.918/2025 SIGE, datë 11.9.2024, të Gjykatës së Apelit të Milanos, e cila ka vendosur shuarjen e dënimit të dhënë ndaj kërkuesit për shkak të parashkrimit, si dhe heqjen e tij nga kërkimi ndërkombëtar, duke i bërë të ditur se nuk kërkon më ekstradimin e tij drejt Italisë. Për rrjedhojë, objekti i kërkesës së kërkuesit është shuar dhe ajo duhet të pushohet.

## III
## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

*A. Për legjitimimin e kërkuesit*

17. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi në objektin e ankimit të tij ka kundërshtuar: i) vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor; ii) ekstradimin e tij në Republikën e Italisë. Ndërkohë, në përmbajtjen e ankimit shtesë kërkuesi, po ashtu, ka kundërshtuar edhe paraburgimin e tij për qëllime të ekstradimit në Republikën e Italisë, paraburgim ky që është vendosur në një procedurë tjetër të veçantë gjyqësore përmes vendimmarrjeve përkatëse të gjykatave të zakonshme.

19. Duke verifikuar kriteret e legjitimimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesa të tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të drejtat themelore të tij, çka do të thotë se ai duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në lidhje me kundërshtimin nga kërkuesi të vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, si dhe të ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, Gjykata, fillimisht, çmon të evidentojë se ekstradimi jashtë territorit, në kuptim të nenit 39, pika 2, të Kushtetutës, rregullohet nga KPP-ja, ndërsa rregullat plotësuese janë parashikuar edhe në ligjin nr. 10193/2009. Sipas këtij kuadri ligjor, procesi i ekstradimit për jashtë shtetit ka natyrë të dyfishtë, duke qenë pjesërisht administrativ për sa i përket veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe pjesërisht gjyqësor, pasi ai mund të lejohet vetëm me vendim gjyqësor, ku në rastin e lejimit është ministri i Drejtësisë ai që disponon përfundimisht për ekstradimin ose jo të një shtetasi.

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se autoritetet e drejtësisë italiane kanë paraqitur kërkesë për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, me të cilin ai ishte dënuar me burgim. Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë i ka dhënë rrugë kësaj kërkese dhe pas kërkesës së prokurorit, në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, me vendimin e kundërshtuar nga kërkuesi, ka vendosur përfundimisht për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë. Në vijim, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, me aktin nr. 2234/2 prot./A.H., datë 14.6.2024, ka miratuar ekstradimin e kërkuesit për në Republikën e Italisë. Megjithatë, ekstradimi i kërkuesit nuk ka ndodhur ndërsa ai ka qenë në gjendje të lirë, ndaj është kërkuar marrja e masave për arrestimin e tij, me qëllim dorëzimin tek

autoritetet italiane. Pikërisht në këtë situatë, përmes ankimit kushtetues individual të kërkuesit, çështja i është paraqitur Gjykatës. Ndërsa ajo ndodhej në pritje për t'u shqyrtuar, Gjykata e Apelit e Milanos, Itali, me urdhrin N. 918/2024, datë 11.9.2024, ka vendosur shuarjen e dënimit me burgim të dhënë ndaj kërkuesit, për shkak të parashkrimit sipas ligjit italian. Nisur nga kjo, me shkresën Ref: EA 126 (2015) AR, datë 10.3.2025, autoritetet e drejtësisë italiane kanë revokuar kërkesën për ekstradimin e kërkuesit në Republikën e Shqipërisë, duke ua përcjellë atë autoriteteve të drejtësisë shqiptare. Në vijim, ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, me aktin nr. 1034/9 prot.A.H, datë 23.6.2025, ka revokuar aktin miratues të ekstradimit të kërkuesit në Republikën e Italisë, për shkak të revokimit të kërkesës për ekstradim nga autoritetet italiane në kushtet kur me vendim të gjykatës italiane dënimi me burgim i kërkuesit ishte shuar.

22. Në situatën faktike në momentin e shqyrtimit të çështjes, Gjykata vlerëson se, ndonëse në kohën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual dhe referuar fakteve të bëra asaj prezente kërkuesi legjitimohej *ratione personae,* ky përfundim nuk mund të qëndrojë në rrethanat aktuale. Në vlerësim të Gjykatës, ky kriter legjitimimi plotësohet vetëm në aspektin procedural, por jo edhe në atë substancial. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se qëllimi i ankimit kushtetues individual dhe interesi i kërkuesit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për lejimin e ekstradimit dhe të procesit të ekstradimit është pikërisht garantimi i së drejtës për të mos u ekstraduar. Në rastin konkret, kërkuesi as nuk është ekstraduar dhe aktualisht as nuk ka ndonjë procedurë ekstradimi aktive. Kërkesa për ekstradimin e kërkuesit është revokuar nga autoritetet e drejtësisë italiane dhe nuk ka asnjë masë efektive për ekstradimin e tij në Republikën e Italisë, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim sipas vendimit penal nr. 2858/2005, datë 13.6.2005, të Gjykatës së Apelit të Milanos, Itali. Për më tepër, dënimi me burgim, që qëndronte në themel të kërkesës për ekstradimin e kërkuesit, tashmë nuk ekziston më, pasi është shuar me vendim të gjykatës italiane. Në këtë kuptim, situata që shkaktoi shkeljen e pretenduar të së drejtës së kërkuesit për të mos u ekstraduar ka ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme, duke mos pasur më asnjë rrezik për ekstradimin e tij në Republikën e Italisë me qëllim ekzekutimin e atij dënimi me burgim. Për pasojë, për sa kohë nuk evidentohet që ndonjë aspekt i së drejtës kushtetuese të pretenduar si e shkelur të jetë ende në rrezik, ankimi i kërkuesit ka humbur qëllimin thelbësor, pra mbrojtjen e së drejtës për të mos u ekstraduar dhe, në këtë kuptim, nuk evidentohet pasja nga ai e një interesi substancial. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur për lejimin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë, si dhe për procesin e ekstradimit të tij në Republikën e Italisë.

23. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për cenimin e lirisë personale, të ngritura në përmbajtjen e ankimit të tij kushtetues individual shtesë, Gjykata vëren se ndonëse legjitimohet *ratione personae,* ankimi i tij nuk përmbush kriterin e legjitimimit *ratione temporis,* në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret kërkuesi ka ngritur pretendime për paraburgimin e zbatuar ndaj tij, me qëllim ekstradimin në Republikën e Italisë, për periudhën deri në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë (nr. 1242, datë 20.12.2022), e cila vendosi mospranimin e kërkesës për ekstradim dhe urdhëroi lirimin e tij nga paraburgimi, pra për periudhën 15.2.2022-20.12.2022. Në kushtet kur ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 24.12.2024, pas më shumë se 2 vjetësh edhe nga heqja e kufizimit të lirisë personale, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është ngritur përtej afatit ligjor 4-mujor, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të rrëzohet, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 6.11.2025.**
**Shpallur më 27.1.2026.**

**Kryetare:** Holta Zaçaj
**Anëtarë:** Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi, Marjana Semini

**VENDIM**
**Nr. 127, datë 16.1.2026**

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE "FONDI NË MBËSHTETJE TË NDËRMARRJES SOCIALE PËR PERIUDHËN 2026–2028"**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen, e:

- znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi; anëtare;
- z. Besnik Çina anëtar;
- znj. Keida Qirko; anëtare;
- z. Ahmet Mançellari; anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës, të datës 16.1.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, mori në shqyrtim njoftimin e skemës së ndihmës shtetërore të njoftuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për mbështetjen e ndërmarrjes sociale nëpërmjet "Fondit në mbështetje të ndërmarrjes sociale për periudhën 2026–2028".

**I. Procedura**

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), me shkresën nr. 4575 prot., datë 21.11.2025, me lëndë "Dërgohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi 'Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028'", ka njoftuar skemën e ndihmës shtetërore "Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale". Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me shkresën 1947/1, datë 5.12.2025, në bazë të nenit 5, të VKM-së nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores 'Për procedurat dhe formën e njoftimit'" kërkoi nga MSHMS-ja plotësimin e formularit të njoftimit. MSHMS-ja, me shkresën nr. 4575/2, datë 29.12.2025, "Dërgohet formulari bazë për njoftimin e ndihmave shtetërore lidhur me projektvendimin e Këshillit të Ministrave 'Për format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit të ndërmarrjeve sociale për periudhën 2026–2028'". Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

**II. Përshkrimi i masës**

2. *Qëllimi*: Mbështetja me grante nga buxheti i shtetit nëpërmjet "Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale" për ndërmarrjet sociale që kontribuojnë në mbrojtjen shoqërore dhe mbështetjen e grupeve të pafavorizuara, nëpërmjet punësimit të tyre dhe ofrimit të shërbimeve për to.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës:* Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në nenin 26, të ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton se ndërmarrjet sociale mbështeten nga shteti nëpërmjet subvencionimit të tyre ose të punonjësve në këto subjekte, format e të cilit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas vlerësimit të bërë nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore. Referuar njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS), është parashikuar mbështetje buxhetore sipas projektvendimit të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028", në zbatim të detyrimeve ligjore për promovimin e masave financiare për këto subjekte.

4. *Kohëzgjatja:* Skema e ndihmës do të zbatohet në periudhën 2026–2028.

5. *Dhënësi i ndihmës dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës:* Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

6. *Përfituesit:* Përfitues janë ndërmarrjet sociale, në kuptim të ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".

7. *Shtrirja sektoriale dhe territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. *Forma dhe vlera e ndihmës:* Buxheti i skemës në formën e grantit është 210,000,000 lekë, për periudhën 2026–2028. Në projektvendimin e Këshillit të Ministrave të referuar në formularin e njoftimit është parashikuar se një ndërmarrje sociale

do të financohet nëpërmjet: 1. subvencionimit të pagës minimale; dhe 2. i sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore.

**III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore**

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson nëse plani i ndihmës shtetërore përbën ndihmë shtetërore, në kuptim të nenit 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, përcakton, se:

*"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara, ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore."*.

11. Gjithashtu, neni 71 "*Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike*", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane, të shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë,[3] përcakton, se:

"*Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87, të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."*.

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) përzgjedhja; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Plani i ndihmës do të financohet nga buxheti i shtetit i miratuar për MSHMS-në. Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Komisioni vlerëson se subvencionimi i ndërmarrjeve/i punonjësve nga grupet e pafavorizuara në këto subjekte përbën një masë mbështetëse që synon mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël. Ky subvencionim akordohet nga burimet shtetërore dhe u jep një avantazh ekonomik ndërmarrjeve që mbajnë statusin "Ndërmarrje sociale" në raport me operatorët e tjerë në treg, pasi këto subjekte ushtrojnë veprimtari ekonomike në prodhim mallrash apo ofrim shërbimesh. Megjithëse këto subjekte kanë qëllim social, Komisioni vlerëson se plani nuk cenon funksionimin e rregullt të tregut të brendshëm dhe nuk shkakton shtrembërim të konkurrencës me ndërmarrjet e krijuara në treg apo me vendndodhjen e faktorëve të prodhimit.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, plani i ndihmës është ndihmë shtetërore, e cila është e ndaluar përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj.

**IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës**

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, i cili parashikon:

*"Ndihma "De minimis" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh."*.

Mbështetur në kreun II, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës '*De minimis*'", vlera maksimale e lejuar e ndihmës, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës përcaktohet si vijon:

*1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:*

a) *vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;*

b) *ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për*

[3] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e 'Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare'".

*konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.*

Në kreun III, "Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit", të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, përcaktohet se: "1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente".

Sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 605/2016, ndihma "*De minimis*" lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

*a) vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;*

*b) ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.*

Dhënësi i ndihmës do të akordojë dhënien e ndihmës shtetërore në formën e grantit nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet sociale në një shumë, e cila nuk kalon 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Sa më lart, Komisioni vlerëson se plani i ndihmës shtetërore "*De minimis*" është i lejueshëm në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e ndihmës shtetërore në formën e grantit "Fondi në mbështetje të ndërmarrjes sociale 2026–2028", të propozuar nëpërmjet projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028", në zbatim të detyrimeve të nenit 26, të ligjit nr. 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".

2. Çdo përfitues i ndihmës duhet të nënshkruaj deklaratën e ndihmës "*De-minimis*" dhe të dorëzoj një kopje të deklaratës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Vlera totale e ndihmës së dhënë një ndërmarrjeje nuk duhet të kalojë 14.000.000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe impaktin ekonomik të skemës.

4. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE
**Kryetar**: Delina Ibrahimaj
**Anëtarë**: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2026/02/02 14:55:28 +02'00'
5b989cc6beaf40f3906b6f5651cae6ca2

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*